

BIBLIOTEKA

E

854-32

T 85

SHTETIT

GJIROKASTËR

FLAMUR TOPI

TINGUJ TË HARRUAR

*Tregime
shkencore*

891.983-32

T 85

S

FLAMUR TOPI

TINGUJ TË HARRUAR

(Tregime shkencore)

53639

3155

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

DY FJALË PRINDËRIT DHE MËSUESIT

Në këtë vëllim, të pregatitur posaçërisht për prindër dhe mësues, nuk bëhet fjalë për sëmundje, të cilat me një shpërthim të vrullshëm shenjash dhe temperaturë të lartë dashur pa dashur alarmojnë edhe më indiferentët .. Jo, këtu është fjala për ato sëmundje që nuk bien menjëherë në sy si të tilla, po që në paraqitjen e jashtme duken si kapriçio e vese të këqaja, që gjoja i ka fituar i vogli.

Pikërisht, duke mos njohur veçoritë karakteristike të këtyre sëmundjeve, shpesh prindërit apo pedagogët gabojnë rëndë në trajtimin e fëmijëve apo nxënësve të tyre.

Pa përjashtim, sëmundjet e përshkruara në këtë vëllim, megjithë seriozitetin e tyre, duke marrë parasysh veçoritë anatomo-fiziologjike të moshës femino-re, aftësinë e mrekullueshme ripërtëritëse të tyre, sukseset e shkëlqyera që ka arritur mjekësia jonë dhe ajo botërore janë krejtësisht të shërueshme! Madje, edhe për sëmundjen e daltonizmit, e cila deri në kohët e fundit konsiderohej si një gjëndje e pa shpresë, shkencëtarët njoftojnë për përdorimin me sukses në disa raste të ultratingujve, tashmë të mirënjohur për lexuesit tanë. Sidoqoftë, zbulimi i hershëm i gjëndjeve të tilla të sëmura ka një rëndësi të posaçme për shëndetin, formimin intelektual dhe sidomos jetën e fëmijëve. Mjafton të mendoni se pas çdo përparimi të dobët, pas çdo sjelljeje të keqe, arrogante, pas çdo

ndryshimi të psiqikës së të voglit mbase fshihet ndo-
një sëmundje...

Askush më shumë se prindërit dhe mësuesit s'do të mund të zbulonte që në fillim shenjat më të para të sëmundjeve me të cilat do të keni rastin të njiheni në këtë vëllim, askush më shumë nuk do të ndihmonte në parandalimin e gjëndjeve të tilla të sëmurës... Le të jenë pra këto shkrime një ndihmës sado modest në punën tuaj aq fisnike për rritjen dhe edukimin revolucionar të rinisë sonë heroike, optimiste dhe të shëndetshme për të cilën gjëndjet e sëmura të përshkruara janë veçse një përjashtim.

AUTORI

«CHOREA MINOR»

Jo, mësuesja Adelinë, atë mëngjez të bukur dimri, nuk kishte ndërmend të ledhatonte Adin e vogël, ashtu siç e kishte pasur zakon më parë, kur djali shkruante bukur e me kujdes.

Nxënësi, sipas mendimit të saj, qe përkëdhelur shumë. Po, edhe ajo kishte gabuar. E pat tepruar me lavdërimet. Dhe shpërblimi? Ajo i hodhi një vështrim të mërzitur fletores së tij, të mbushur me fjali të shkruara cuditërisht keq, e psherëtiu thellë:

— Adi, ke shkruar keq, shumë keq!.. Sot nuk po të vlerësoj, po nesër...

Kështu i pat thënë dhe Adi i qe përgjegjur se ai s'qe fajtor, se dora e vogël i dridhej, se ai... Po ajo nuk i duronte justifikimet e tij.

«Sot përsëri ka shkruar keq. Shkronja të shtrembëra, fjali të dallgëzuara...» — mendoi e trishtuar mësuesja.

— Adi, tjetër herë tregohu më i kujdesshëm, — tha ajo duke ja ngulur sytë vogëlushit. Ky u step papritur dhe e përqeshi mësuese Adelinën...

— Adi! — thirri ajo e zemëruar, — Si guxon?!

Vogëlushi nxori sërish gjuhën dhe fytyra e tij mori një pamje përcmuese.

Adelina u ngrit nga karrigja dhe ju afrua me çape të shpejta. Po fëmija nuk kishte ndërmend të pushonte.

— Nuk kam faj, mësuese, më lëviz vetë fytyra,

gjuha më del vetë jashtë, — thirri Adi i friksuar e, ndoshta, ajo do ta kish besuar, nëqoftëse, fill pas këtyre fjalëve, fytyra e tij nuk do të kish marrë atë pamje të përçmuar.

— Ti s'meriton të rrish në klasë! E dëgjo: nesër të vish me prindët, kuptove?..

Të voglit ju mbushën sytë me lot. Ai do të kishte dashur t'ja thoshte të gjitha mësueses së tij, po ajo nuk e kishte kuptuar, ajo... Dhe Adi s'mundi ta përmbajë veten. Qëndroi në një kënd të koridorit, e mbuloi fytyrën me doçkat e vogla, që i dridheshin shumë.

* * *

Edhe në familje Adin nuk e kuptuan ose, më mirë, nuk e dëgjuan gjer në fund. Të voglin e detyruan t'i kërkonte ndjesë mësueses, gjë që ai e bëri pa dëshirë, sikur ta dinte se herët a vonë do t'i përsëriteshin prapë ato lëvizje të pavullnetshme të fytyrës, të gjuhës...

Adi vazhdonte të shkruante keq. Mësuesja e qortoi ashpër e, fill pas kësaj, «i llastuari» (kështu e thërriste ajo ditët e fundit), e përçqeshi pa pikë turpi.

* * *

Kur kthehej për në shtëpi, mësuesja mundohej të lidhte ngjarjet e ditëve të fundit, të rikujtonte skena të shkëputura të qëndrimit qesharak të Adit. Herë - herë përfytyronte fytyrën e qetë, sytë e zgjuar e të vëmendshëm të nxënësit, të mbërthyer në sytë e saj. Ja tek e shihte atë të përkulur lehtë mbi fletoren e bukurshkrimit, tek shkruante me kujdes çdo fjalë të shqiptuar prej saj. Mirëmbajtja e fletores, bukuria e shkrimit, jo një herë qenë bërë shkas që ajo ta lavdëronte para të gjithëve.

Kurse tani?!

— Adelinë, shoqja mësuese! — dëgjoji ta thërrisnin. Ajo u përmend.



— Oh, doktor Astriti! Më falni, isha kaq e zhytur në mendime! . — thirri ajo.

— Ju kuptova, dhe as që është nevoja të më kërkoni falje, — i buzëqeshi lehtë mjeku, duke i zgjatur dorën.

Një pjesë të rrugës biseduan për gjëra të zakonshme. Befas, sikur të kujtohej, mësuesja i tha:

— Doktor, kam dashur të bisedoj me ju për rastin e një fëmije të çuditshme. Dikur ishte një nga nxënësit e mi më të mirë. . .

Dhe Adelina filloi t'i tregonte historinë e tij.

— A mund të më takoni me vogëlushin tuaj? — e pyeti ai në fund të kallëzimit të saj.

— Pse jo. Mos, ndoshta, mendoni se ai. . .

— Ah, jo, jo, tani për tani nuk mund t'ju them gjë. Sidoqoftë, një ndryshim i tillë, kaq i papritur, nuk më duket i natyrshëm. . . Ndoshta fëmija vuan nga «chorea minor». . .

Frazën e fundit ai e shqiptoi në një mënyrë të tillë, sikur të fliste me vetveten.

Adelina e vështroi e çuditur, pa kuptuar gjë.

— «Chorea minor»? Ç'të jetë vallë kjo? — pyeti mësuesja me dyshim.

— Oh, një term mjekësor. Tani për tani është vetëm një hamendje. . .

* * *

Të nesërmen, Adelina dhe Adi shkuan në klinikën ku punonte doktor Astriti.

Doktori do të kishte dashur t'i buzëqeshte vogëlushit simpatik, po, nëqoftëse e përshëndeti hijerëndë, që i detyruar ta bënte këtë. Ai dyshonte, sipas tregimit të mësueses, për një «chorea minor». E, në dëshironte të përcaktonte një diagnozë të saktë, një qëndrim i tillë që i domosdoshëm, se fenomenet e kësaj sëmundjeje çfaqen së tepërmi gjatë emocioneve të mëdhenj.

Vizita nuk qe e shkurtër, siç kishte pandehur në fillim Adelina.

Doktori i tha Adit të ecte nëpër dhomë dhe, për çudinë e mësueses, ai filloi të bëjë lëvizje të pakontrolluara të krahëve, të supeve e të kokës.

— Djalë i keq, ti jo vetëm që s'shkruan bukur, po s'di as të ecësh mirë!— i thirri me zemërim mjeku.

Zemërimi i tij qe kaq i natyrshëm, sa që mësuesja Adelinë gati-gati e mori si të vërtetë.

I vogli u prek shumë, e ndjeu veten të fyer. Sytë ju mbushën me lot. Befas në fytyrën e tij u pasqyrua një ngërdheshje përcmuese, tallëse, e ngjashme me ato, që Adelina kishte parë në klasë. Fëmija filloi t'i nxjerrë gjuhën doktor Astritit.

Në faqet e skuqura të fëmijës vazhdonin të rridhnin lot të nxehtë.

Mjeku i dha një lugë me shurup dhe e urdhëroi ta pinte.

Adelina nuk u besonte syve të saj. I gjori Adi! Sadoqë u përpoq të fuste lugën në gojë me dorën që i dridhej, nuk mundi.

Befas mjeku i buzëqeshi të voglit, e afroi pranë vetes dhe e puthi fort.

— Kolopuç i vogël, tani e marr me mend se sa shumë të ka munduar sëmundja; po mos u bëj merak, do të të shërojmë shpejt. Ja, ke për të parë...

— E pra, doktor, ç'mendonit?— pyeti mësuesja, së cilës nuk i durohej gjersa të merrte vesh përfundimet e vizitës mjekësore.

— Adelinë, dyshimet tona u vërtetuan. Adi vuan nga sëmundja e ashtuquajtur «chorea minor», apo reumatizmi i trurit, — i tha mjeku mënjanë.

Adelina hapi sytë e habitur.

— Reumatizëm i trurit? Për besë, as që më shkonte ndërmend se ekzistoka një sëmundje e tillë!— thirri ajo.

— Po, po. «Chorea minor» haset vetëm ndër fëmijët. Ajo jua ndryshon mjaft karakterin. Lëvizjet e pavullnetsh-

me të muskujve i japin fytyrës pamje nga më përçmueset, e, gjersa natyra e sëmundjes të bëhet e njohur, shpesh fëmijë të tillë ndëshkohen në shkollë, apo në familje. Shkrimi i tyre është i çuditshëm, mjaft i çrregullt, aq sa një mjek i mirë mund të përcaktojë diagnozën vetëm nëpërmjet tij.

— Oh, po, po, doktor, të gjitha kam patur rastin t'i shoh vetë! — u përgjegj mësuesja.

— Padyshim, dhe nuk e teproj nëqoftëse mendoj se edhe Adi juaj nuk i ka shpëtuar ndëshkimit. Kështu?..

Mësuesja e vështroi të voglin, e afroi pranë vetes dhe e shtrëngoi fort, shumë fort në krahët e saj.

— Më fal, Adi, më fal! Si nuk të kuptova dot më parë?

I vogli u prek edhe më shumë e, si gjithnjë në raste të tilla, fytyra e tij mori një pamje ngërdheshëse. Mësuesja vazhdonte t'i ledhatonte flokët e zinj e sytë e saj filluan të shkëlqejnë, me dritën e gëzimit, që buronte padyshim nga një zemër e dashur, e dhëmshur dhe e mirë. . .

KTHJELLTËSIA

Në klasën e dytë fillore, Teutës së vogël i qe turbulluar shikimi dhe ajo u qe ankuar prindëve për këtë. E kishin vizituar të okulisti dhe ai kishte vërejtur te fëmija shenjat e para të miopisë. Mjeku e kishte këshilluar të mbante syze. Në fillim fëmija kishte kundërshtuar me ngulm, po pastaj qe bindur.

Një ditë u kthye nga shkolla me lot në sy.

— Nuk i dua syzet, nuk i vë më, — thirri ajo duke ngashëryer. — Shokët më thërrasin: «Qorrja me syze!»

E ëma u mundua shumë ta qetësonte e ta bindte se syzet ishin të domosdoshme. Ajo bisedoi me mësuesen e paskëtaj, askush në klasë nuk e shau më. Dalëngadalë u mësua me syzet dhe i mbajti ato, gjer në fund të klasës së tetë. Ndërkohë qe rritur. Kish arritur në moshën e «përkujdesjeve», ndaj syzet i quante si diçka që e shëmtonin, që i fshihnin sytë e bukur e të kaltër.

* * *

Sadoqë ishte ulur në bankën e parë, s'qe në gjen-dje të shihte qartë në dërrasën e zezë. Në raste të tilla, mbyllte sytë përgjysmë për të dalluar më mirë geramat e turbullta. Po mendimi se në qytetin e madh (ku që prej dy muajsh kishte ardhur për studime) nuk e dinin se më parë mbante syze, ishte një farë ngushëllimi për të.

Padyshim, tani shikonte me vështirësi, po të paktën nuk mbante syze!

Madje sytë e saj qenë thellësisht të kaltër, sikur të pasqyroheshin në to deti dhe qielli pranveror.

— Ç'sy të bukur që ke, moj Teuta! Si lum ti! — i thoshin shoqet dhe ajo pushtohej nga një ndjenjë ngazëllimi. Në raste të tilla, i ndjente më pak shqetsimet e mundimet, që i sillte pamja e mjegulluar.

* * *

Muajt e parë, ndërtesën katërkatëshe, që ndodhej në fund të rrugës së konviktit, e shquante mirë. Kurse, më vonë, ndërtesa ishte për sytë e saj një përzierje kaotike dhe e deformuar konturesh të mjegulluara. I dukej se, çdo ditë, ndërtesa sa vinte e bëhej më e turbullt.

Konturet e dritareve filluan të shkriheshin e të bëheshin njësh me fasadën, sikur peneli gjigant i një piktori të padukshëm t'i kishte fshirë e t'u kishte dhënë një ngjyrë.


* * *

Në mësimin e gjuhës, Agroni e teproi, me gjithëmënd prandaj dhe mësuesja që e detyruar të ndërhynte:

— Siç duket, ju përfitoni nga që ndodheni në bankën e fundit! Pa shkëmbeni vendet me Teutën! Kështu s'do të mund të fshiheni prapa kurrizit të shokëve, — i tha ajo.

Kur mësuesja doli nga klasa, Teuta e ndoqi pas, diç kërkoi t'i thotë në koridorin e shkollës, po ndërroi mendje dhe, e mërzhitur, u kthye prapë në bankën e fundit.

Në provimin e algjibrës, ushtrimin e parë mundi ta kopjojë pa vështirësi nga shoku i bankës, ndërkohë



që mësuesi shkruante në dërrasë ushtrimin e dytë e të tretë.

Paskëtaj, një orvatje tjetër e tillë do të qe e rrezikshme. Mësuesi do të pandehte se kërkonte të kopjonte zgjidhjen. Sidoqoftë, ju vu punës për të zhvilluar, të paktën, ushtrimin e parë. E përfundoi shpejt zgjidhjen dhe, vjedhurazi, i hodhi një vështrim me bisht të syrit ushtrimit të dytë të shokut.

— Kujdes, Teuta! — i tërhoqi vëmendjen mësuesi. Shokët e klasës vështruan një çast nga ajo.

«Eh, mësues! Ai ende s'e ka zgjidhur ushtrimin e parë! S'dua tjetër, veçse ushtrimet të kopjoj. Kaq e asgjë tjetër, asgjë», — mendoi.

Po qe e vendosur të mos i lëshojë armët. Kur mësuesi i qe afruar dritares dhe vështronte në rrugë, ajo u përkul lehtë nga shoku i bankës.

« $a^2 + b^2 \dots$ minus... minus. Hej, ç'punë, s'po e shoh dot! Hej, sa të vockëla i bën këto germa! Ah, po, minus $c^2 \dots$ »

Po befaz zëri i mësuesit e prapsi në vend, dhe ajo mbeti si e ngrirë.

— Teuta! Përse mundohesh më kot të më gënjesh? E ç'rëndësi do të kishte për ty dhe për cilindo tjetër, një zgjidhje e kopjuar?

E tronditur, Teuta uli kokën dhe s'mundi ta përmbajë veten. Trupi i dridhej i tëri nga ngashërimet.

Mësuesi e akuzonte përpara të gjithëve si «mashtruese» dhe ai ishte po aq «fajtor», sa ç'mund të ishte edhe ajo vetë.

* * *

Pas disa ditësh u sollli rezultatet.

— Teuta, ke zgjidhur vetëm një ushtrim: dy të tjerat, as që ke marrë mundimin t'i shkruash. E prisja këtë! Mënyra se si kërkoje të përfitoje nga shokët, më bindi... — tha ai ftohtë dhe i dorëzoi fletën e provimit.

Atë natë bëri një gjumë të shqetsuar, të mbushur me ëndërra.

Njëherë ju bë se i kishte vënë prapë syzet me r Rathë argjendi. Tek përshëndeste e drojtur shokët, ata e tregonin me gisht, i afroreshin, i preknin syzet gjigante e ja plasnin gazit.

«Ajo qenka dritëshkurtër! Kurse ne na mburrej me sytë e saj të kaltër! Sytë e saj janë si të bretkosës! Bretkosës ha - ha - ha! . . .»

Dhe vetëm njëri prej tyre, Agroni heshtte! Qëndronte mënjanë i zyrtë dhe i heshtur. Ajo, si për të gjetur mbrojtje e ngushëllim, u mat t'i afrohej, po ai, si t'ja kishte kuptuar qëllimin nxitoi të largohej.

E dëshpëruar, duke u lutur, ajo zgjati duart nga ai.

«Dritëshkurtër, dritëshkurtër, dritëshkurtër!» — thirri pastaj Sandri me zë të fortë, aq të fortë, sa muret e ndërtesës katërkatëshe u drodhën dhe u lëkundën, si të ishin prej kartoni.

Befas i doli gjumi. Qe mbytur në djersë të ftohta e zemra i përpëlitej fort në krahëror. Qe ende natë. Yjet e «mjegulluar» lëshonin rreze të zbeta mbi qytetin e madh, që flinte thelië.

* * *

Në kinema rastisi të ulej në një radhë me mësuese Dhuratën.

— Eja, Teutë! — i tha ajo, kur pa vajzën që mundehej të gjente vendin e lirë. — Vendi yt është këtu!

Ajo u skuq lehtë dhe u ul në karrige.

— Teuta, konviktit tonë i paskan rezervuar biletat më të mira, se radha 12 e lart kështu sikur mbahet, — i tha mësuesja e kënaqur.

— Po, mësuese, radha është e mirë, — ju përgjegj nxënësja, duke i buzëqeshur mendueshëm.

Pas pak filloi filmi. Vajza me sytë e kaltër qe ulur në një radhë me shoqet, po ndërkohë i dukej sikur nda-

hej prej tyre nga qindra radhë dhe se qe ulur në një pikë shumë të largët... Së andejmi shihte imazhet e turbullta, të personazheve e të përkthimeve.

Ajo qëndronte e ngrirë dhe thujse e palëvizshme, si të ishte mbërthyer në karrige. Madje nuk lëvizti edhe kur Drita trupgjatë i zuri tërë pamjen e ekranit. E përse të përpiquej të përkulte lehtë kokën? Për të parë më mirë? Ç'pyetje të hidhur që i bëri vetes!

Drita u mënjanua lehtë dhe i zbuloi sërish kuadrin. Ajo, instinktivist, vazhdoi të ndjekë, me vështrimin e mjegulluar e të ethshëm, lëvizjen e çrregullt të figurave të turbullta në ekran, të dëgjojë zëra të ndryshëm spektatorësh, zhurma të çfarëdoshme, pa mundur të orientohej sadopak në atë mugëtirë cfilitëse.

«Po të mbaja syze, s'do të vuaja kështu! — mendoj e pikëlluar. — Sikur t'i vija prapë?! Oh, një fjalë goje! T'i vësh?! Eh, gjersa t'u mësohen sytë, shokët, shoqet do të më shohin me sy tjetër... ashtu si shokët e klasës së dytë. Pastaj, tani jam e rritur! Janë të rralla shoqet e moshës sime që do të pranoin në vinin syze.

Oh, sytë më lodhen, po e kam vendosur. Njëmijë herë më shumë vuaj kështu, se sa të vë syze!»

— A të pëlqen filmi, Teuta?! — i pëshpëriti në errësirë mësuesja, duke u përkulur lehtë nga ajo.

— Shumë, mësuese! — u përgjegj vajza e ndjeu t'i përloreshin sytë.

Ardhja e mjekut okulist në klasën e tyre qe një e papritur e hidhur për sy - kaltrën.

Shokët vështronin me kureshtje e të përqëndruar tabelën e përcaktimit të mprehtësisë së pamjes, të mbushur me germa të llojeve e të madhësive të ndryshme, po për atë, tabela ishte një përbindësh, që do t'i nxirrte të fshehtë në shesh...

Një çast mendoj të dalë nga klasa me një shkak bindës, po «përbindëshi» dukej se e kish mbërthyer me germat e turbullta. Atëhere u dorëzua dhe vendosi t'i nënshtrohej provës, si të tjerët.

Duke drejtuar shkopin metalik nga radha e fundit e germave më të vogla, mjeku pyeti:—Ç'germë është kjo, Teuta?

Në klasë sundonte heshtja. Sytë gjysmë të mbyllur, u vërtitën disa herë më kot mbi vazhdën e germave të turbullta.

— Po kjo?—pyeti mjeku, duke u ngjitur me shkopin një radhë më lart, në serinë e germave më të mëdha.

Sërish sykaltra nuk mundi të përgjigjej dhe ju duk se përbindëshi-tabelë ckërmiti «dhëmbët figura» e pastaj ja krisi të qeshurit!

Shkopi i çeliktë u ngjit një radhë më lart e ajo pat përshtypjen e çuditshme se zbriti edhe një shkallë më poshtë, drejt një honi të frikshëm.

— Po kjo germë, ç'është? — pyeti mjeku me të butë, si t'i vinte keq.

Ajo vendosi papritur të përgjigjej. Duhej ta bënte këtë, sidoqë germën e turbullt s'e shquante dot. Kishte mundësi të qëllonte në shenjë.

— B!—u përgjigj sikur të fliste me vetëveten.

— Jo, Teuta, jo! Vështro mirë!..

Sundoi sërish heshtja.


— Kjo germë? Po, kjo? Kjo, kjo, kjo! — Ajo përgjigjej me një «jo» të pasigurtë, të dredhur.

— Shpresoj se këtë vështirësi e ke ndjerë prej kohësh! — i tha mjeku.

Ajo pohoi lehtë me kokë, e tronditur.

— Miopia juaj mund të korigjohet lehtë, po qe se do të mbani syze! Jua këshilloj me gjithë zemër këtë, përndryshe të parët do t'ju keqsohet më shumë... Shoku mësuës, duhet ta sillni këtë vajzë në bankën e parë!

Dhe mësuësit, me duar të kryqëzuara në gjoks e i mbështetur në dritare, i bëhej se shihte fletëzën e provimit të sykaltrës me një ushtrim të mbaruar e një



tjetër të nisur, i bëhej se e shihte tek përkulej lehtë mbi fletoren e shokut, e drojtur dhe e turpëruar.

Duke buzëqeshur, mjeku i përsëriti kërkesën mësuesit dhe ai, duke u përmendur, u përgjegj:

— Po, po, që tani!

* * *

«Oh, sa keq kam menduar!» — thirri Teuta duke vështruar me dashuri shokët e klasës tek ngjiteshin në të përpjetën e kodrës së liqenit artificial. «Paragjykimet më mundonin e më bënin të vuaja! Druaja se, me të vënë syzet, shokët e shoqet s'do të më vlerësonin si më parë. Oh, ç'mendim i marrë!»

— Hej, Zana, Drita, Agron, pritmëni! — u thirri ajo me gaz shokëve e nxitoi t'i arrijë.

Grupi i gëzuar i të rinjve u ngjit në pikën më të lartë të kodrës. Së andejmi, vështrimet e lumtura të të gjithëve, si rreze të ndritshme, ranë mbi qytetin e madh, që kishte filluar ta mbulonte muzgu i mbrëmjes.

Aty këtu filluan të ndizen dritat e para. Duke drejtuar gishtin tregonjës diku, midis dhjetra apartamenteve të largëta, ajo thirri e emocionuar:

— Hej, Zana, Agron, pa shihni konviktin tonë! Tarracën tonë! Stadiumin!.. Autobuzin!..

Ajo s'pushonte së treguari objektet e largëta e shokët, shoqet, mësuesja që i qe afruar në heshtje, qeshnin gëzueshëm.

Pastaj, të zënë dorë për dorë, me këngë partizane në gojë, eskursionistët zbritën tatëpjetë udhës së asfaltuar dhe, kur dolën në sheshin e madh të universitetit, në bulevardin «Dëshmorët e Kombit», filluan të ndizehin njëra pas tjetrës llambat me neon...

TINGUJ TË HARRUAR

Ai u ngrit nga shtrati me kujdes që të mos zgjonte shokët e dhomës, që sapo kishin rënë të flinin, dhe me çape të lehta përshkoi koridorin e ngushtë midis dy radhë shtretërish.

— Hej, Dritan, ku shkon? — i pëshpëriti Sokoli, që s'e kish zënë ende gjumi.

— Më duket se dëgjoj tinguj të mrekullueshëm. Ah, nuk di të t'i përshkruaj! Trembem se mos i harroj... andaj dhe po nxitoj t'i hedh në pentagramë... Profesor Mirdashi s'do të dëshironte dhuratë më të mirë për ditëlindjen! — tha ai me një frymë dhe nxitoi të dalë.

— Hej, çfarë s'bën frymëzimi! — mendoi Sokoli, duke buzëqeshur lehtë në gjysmëerrësirën e dhomës.

* * *

Dritani hyri në dhomën e provave dhe, me duart që i dridheshin nga emocionin, hapi dritaren e vështroi një copë herë me ngazëllim hënën e ndritshme të asaj nate vjeshtake.

— Sonte do të të bëjnë shoqëri tingujt e mi! — pëshpëriti ai me vete dhe, duke vënë buzën në gaz, u drejtua nga pianua.

Tinguj të ëmbël mbushën dhomën. Pas kësaj ai s'pa-ti më kohë të mendonte asgjë. Ai zuri të luante në piano melodinë e re. Lozte me shkathtësi në tastierat e bardha e

të zeza, duke kujtuar se kishte krijuar, padyshim, melodinë më të bukur të jetës së tij studenteske.

Kur mbaroi së luajturi, shtriu duart me gishtrinjtë e hapur fort, për t'i çlodhur, e vështrimin ëndërrimtar e përqëndroi në kupën e errësuar të qiellit të mbrëmjes.

Një dorë u mbështet në supin e tij. Ai ktheu kokën i trembur, po sakaq i buzëqeshi me dashamirësi «prishësit të qetësisë».

— Oh, qenke ti, Sokol?! — tha ai i prekur.

— Po, Dritan. Tingujt fluturuan nga kati i dytë dhe erdhën gjer në dhomën tonë. Ata tingëllonin kaq bukur në heshtjen e natës, sa, besomë, u magjepsa. Erdha të të dëgjoj nga afër...

— Të pëlqen? — pyeti Dritani me një frymë.

— Gjersa erdha... merre me mend. Është e mreku-llueshme... Veçse një fragment... sikur më kujton, ... oh, s'di ç'të them, një krijim, që diku e kam dëgjuar... Por më thotë mendja se kjo është vetëm një përshtypje...


— Ashtu mendoj edhe unë! — i buzëqeshi ëmbël Dritani. Ky është një krijim që më përket vetëm mua. Melodia më erdhi ndërmend, më pushtoi të tërin, më bëri të dridhem, të vuaj, madje të ngazëllem dhe s'munda më... Po të kisha pritur mëngjezin, do t'i vrisja me duart e mia këta tinguj...

— Je i lodhur?

— Shumë! Po kryesorja është se jam i lumtur! Melodinë do ta ruaj të fshehtë e këtë dhuratë jo të zakonshme, nuk do t'ja bëj të njohur mësuesit tim, veçse pak kohë para fillimit të mbrëmjes...

— Mendimi s'është i keq! E papritura në të tilla raste është e këndshme. Kurse tani eja! Duhet të çlodhesh...

Të dy mblodhën fletët e pentagramit, të shkruara me nxitim, mbyllën pianon e, duke i hedhur me dashamirësi duart në supe njëri tjetrit, dolën në koridorin e heshtur.



Ditën e 60 vjetorit të lindjes, mësuesin e muzikës, Mirdashin, s'e zinte vendi. Mësuesin pensionist të muzikës e kujtonin ish nxënësit e tij, kolegët, miqtë, të afërmit.

Programin e asaj feste e hapi grupi i ish nxënësve të tij, që, të shoqëruar nga mandolinat, kënduan këngë të ndryshme patriotike, partizane, këngë popullore e të kohës. Pas pak, të rinjtë shkollarë i pasuan edhe të ftuarit: gra, burra, madje edhe pleq. Ishin çaste vërtet prekëse e të paharrueshme.

Përpara të gjithëve doli Sokoli. Vështrimi kureshtar i të ftuarve u mbërthye te djaloshi i shkathët.

— I dashur mësuesi ynë i muzikës! Dritani, të cilit i mësuar lëvizjet e para në tastierat e pianos dhe i ushqyet zellin, durimin dhe dashurinë për botën e mrekullueshme të muzikës, ka kompozuar për ju një pjesë muzikore. Ju ftojme ta dëgjoni.

Dritani përshëndeti dhe ju afrua pianos. Të ftuarit duartrokitën ngrohtësisht. Një e skuqur e trëndafiltë i kish mbuluar fytyrën. Fërkoj lehtë gishtrinjte, priti gjersa në sallë u bë heshtje e plotë, pastaj nisi të luante.

Të gjithë i kishin ngulur sytë te ai dhe dëgjonin me vëmendje tingujt e lehtë, melodiozë, të gëzuar e të freskët, që mbushnin dhomën. . . Mësuesi plak ndiqte me një vështrim të ethshëm lëvizjet e shkathëta të gishtrinjtë të gjatë mbi tastierat. Befas ju duk se gishtrinjtë e gjatë filluan të zvogëloheshin shumë shpejt e u shndërruan në gishtrinjtë e vegjël e delikatë të Dritanit 12 vjeçar. Tani ai shihte të ulur përballë tij pianistin e vogël zeshkan tek luante me zell koncerte të ndryshme për piano e orkestër. Qe një fëmijë e talentuar e ai qe për-pjekur t'ja zhvillonte më tej prirjen . . . Fëmija ishte rritur përpara syve të tij. Qe bërë burrë, burrë!.. «Hej, sa shpejt që u rritkan nxënësit! — mendoi i mallëngjyer. — Shumë shpejt!..»

— Dëgjoni, doktor! — u kthye mësuesi nga miku i tij, që ish ulur përbri. — Nxënësi im është një talent i

vërtetë! Një kompozitor i ardhshëm! Muzika e tij është origjinale, e lehtë, e gëzuar, optimiste, e çliruar plotësisht nga influencat. . .

Mjeku e miratoi në heshtje me kokë!

— Talente të tilla të gëzojnë. Janë e ardhmja e muzikës sonë. Në mos gaboj. . . ju. . .

Papritur, profesori i shtrëngoi lehtë krahun. — Më falni, doktor, — tha ai me gjysmë zëri, i turbulluar, duke i vënë veshin më shumë melodisë, sikur të donte të mos i shpëtonte qoftë edhe një tingull.

«Jo, jo, s'është e mundur, nuk është! — mendoj. — A thua të ketë kopjuar koncertin e Mendelsonit? Po, s'ka pikë dyshimi, që është po ajo vijë melodike. Ç'e detyroi ta bënte këtë? . . . Çfarë?»

Prapa tij u dëgjuan pëshpëritje e pastaj një e qeshur e mbytur. Ai ktheu kokën. Genci që përkulur lehtë nga dy shokët, që qenë më të djathtë, e diç u thoshte me zë të ulët. Pastaj të tre qeshën mbyturazi, duke vështruar nga pianisti i ri.

«Identike!» Kjo që e vetmja fjalë e shqiptuar prej Genci që mundi të rrokë veshi i dobësuar i mësuesit.

«Ah Genci, Genci», — psherëtiu mësuesi dhe në atë çast ju kujtua ajo orë kujdestarie, kur Dritani, Sokoli e shokë të tjerë të klasës e kishin qortuar Gencin për imitime të ndërgjegjshme në muzikë. Mos ndoshta Genci kërkonte të hakmerrej?!

— Mirdash, ju. . .

— Ah, po, — u përmend mësuesi. — Më falni, doktor! Punë pleqsh, vëlla! Çoku e humbasim ngadonjëherë mendjen. . .

— Melodia është e mrekullueshme, — foli i entuziazmuar mjeku.

— Ç'ka. . . s'është e keqe! — u përgjegj pa qejf mësuesi.

— Ju, mësuesit, jeni të kursyer në vlerësimin e nxënësve tuaj dhe sigurisht këtu s'ka asgjë të keqe. Kështu,

nxënësi nuk pandeh se kapi qiellin me dorë dhe vazhdon të jetë kërkues ndaj vetëvetes.

— Po, po, është ai vetë, koncerti... — foli mësuesi me vështrimin e çoroditur e të hutuar, të ngulitur në profilin e Dritanit të tij.

— Çfarë thoni, profesor? — pyeti mjeku, i habitur me përgjigjen pa lidhje të Mirdashit.

— Desha të them se... se një qëndrim i matur, i kursyer, në lëvdime, është gjithnjë më i dobishëm, se sa një lëvdim i parakohshëm.

Mësuesi u hodhi një vështrim hetues të pranishmëve. Shumica e ndiqnin melodinë, të përqëndruar e të emocionuar. Ata s'ja shqitnin sytë pianistit të ri zeshkan, me leshrat e zeza, që i mbulonin ballin e gjerë, të mbushur nga bula të mëdha djerse. Kurse Genci ndërronte vend që t'u afrohej shokëve të një grupi tjetër.

Kur Dritani mbaroi së lojturi, shumica e të ftuarve e duartrokiti nxehtësisht, kurse mësuesi qëndroi ftohtë.

«Mbase s'e ndjen veten mirë! — u mundua të ngushëllonte veten Dritani, duke e gjykuar mësuesin nga ngjyra e zbetë dhe shprehja e mërzitur e fytyrës, — sepse është e pamundur që këta tinguj të bukur të mos i kenë pëlqyer. Kur u ula në stol, dhjetë minuta më parë, që krejt ndryshe. Më duartrokiti, mbase më fort nga të gjithë, kurse tani...»

Ende s'qe shuar jehona e duartrokitjeve dhe e përshëndetjeve, që miqtë e dashamirësit i drejtonin pianistit të ri, kur Genci, me gjallëri, tha:

— Profesor! Dy vjet më parë na ftuat për të dëgjuar pllakat tuaja më të mira. Njëra syresh na pëlqeu shumë e mbase edhe për ju ishte koncerti më i preferuar! Më lejoni, profesor, t'ju drejtoj një lutje në emër të disa shokëve, për të zgjedhur pllakën tonë të preferuar. Do të ishim të lumtur ta dëgjonim!

I tronditur, mësuesi u mbështet më shumë në karriçe dhe s'e vështroi në sy.

— Zgjidhni vetë! Ja tek janë pllakat, — foli ai i turbulluar.

Genci kërkoi me nxitim ndër dhjetra pllaka e së fundi psherëtiu i lehtësuar.

— Ja tek është! E gjeta! — tha me zë të lartë. — Është një koncert për piano i të madhit Mendelson.

Ai e vuri pllakën në gramafon e së andejmi u hodhi një vështrim provokues të gjithëve. Në dhomë u përhapën tingujt e koncertit të famshëm, të cilit, në një pjesë të ndjeshme, i gjasonte aq shumë «kompozimi» i fundit i Dritanit.

Në sallë filluan të pëshpërisnin:

— Një krijim i denjë dhe i bukur. S'ke ç'i thua!

— Një dhuratë ditëlindjeje!

— Talent i madh!

— Idem! Idem! Idem!

Profesori kishte shtangur e qe zbehur në fytyrë, sikur të mos i kishte mbetur pikë gjaku. S'guxonte të ngrinte sytë. Ja edhe nxënësi i tij i talentuar! Krenaria e tij! Dritani dukej sikur kishte ngrirë. Me sytë e hapur jashtë masës, që shikonin ngultas rrotullimet e pllakëzës, dukej si një i sëmurë i mbërthyer nga kllapia e etheve të forta. Çdo ëndërr e bukur, çdo përfytyrim, që ishte krijuar në fantazinë e tij të gjallë për këtë natë të gëzuar, po shembej përpara syve të tij me shpejtësi të habitshme dhe ai e ndjente veten krejt të pafuqishëm t'i ndalte hovin kësaj të papriture të rrezikshme. Kishte përshtypjen se çdo pjesë e trupit tanimë kishte humbur vitalitetin e saj, qe mpirë e ftohur, qe bërë e palëvizshme. Ëndërrat, përfytyrimet, duartrokitjet ai i shihte të mbledhura në pëllëmbën e Gencit. Ja tek e shihte atë shuplakë të mbli-dhej grusht, t'u merrte frymën ëndërrave të tij, t'i bënte ato të dridheshin e të copëtoheshin në miliona pjesëza mikroskopike. Befas pllakëza ngeci në vend, e melodia filloi të përsëritej në mënyrë monotone e cfilitëse për nervat e tij. Një herë, padashur, ai kishte tendosur jashtë masës telat e violinës së tij. Ai e ruante ende të gjallë lu-

hatjen e gjatë të telave, që nga çasti në çast mund të këputeshin. Dhe, për çudi, edhe ai që pushtuar nga ndjenja, gjer atëhere e panjohur, e tendosjes së nervave të tij. Shuplakat nervoze të Dritanit u mbështetën fort në tëmthat dhe ai ndjeu përplasjen mbi to të artereve të fuqishme, që atë mbrëmje kishin humbur, — ndoshta për të parën herë në jetë — qetësinë dhe ritmin e lëvizjes.

Ata tinguj kokëfortë e kryeneçë, që përsëriteshin në të njëjtën trajtë, i bëhej se e akuzonin, pa ndjerë për të keqardhje.

«Do - re - si - fa. Dritani ka imituar Mendelsonin. Dore - si - fa. Imituar - imituar Do - re - si - fa».

— Oh, mjaft, mjaft! Po luaj mendsh! — thirri ai duke u dridhur i tëri dhe me një lëvizje të dëshpëruar rrëmbeu pllakëzën. — Ajo është muzika ime, imja! S'kam kopjuar asnjëri. S'kam patur nevojë ta bëj këtë.

— Jo, kurrë! Dritani s'është fajtor! Duhet akuzuar Mendelsoni për imitim! Madje ai ka kopjuar Dritanin, — tha me shpoti Genci.

— Qetësohu, çlodhu, Dritan, — ju drejtua mësuesi dhe e ndihmoi të ulet në stolin e pianos. — Ç'ndodhi kështu me ty? Ti s'e ke turpëruar kurrë veten.

— Më duket vetja si në ëndërr. S'më vinte kurrë ndërmend se po hidhja në pentagramë melodinë e një tjetri. Tingujt më erdhën papritur në kokë. I pandeha si një krijim, që më përkiste mua. Atë natë, profesor, isha i frymëzuar, i pushtuar nga një ekzaltim, që rrallë e kam ndjerë...

— Ai nuk ka kopjuar! — u dëgjua zëri i fortë dhe i dëshpëruar i Sokolit. — Ju betohem për këtë që ju them! E kam parë me këta sy... U ngrit nga shtrati, kur të tjetrët flinin, e zbriti i emocionuar në dhomën e vogël të provave. Pa asnjë partiturë të ndonjë tjetri, nisi, i frymëzuar, të hedhë në pentagramë ata tinguj të madhërishëm. Të tillë e kam parë gjithnjë, sa herë krijon diçka të tijën. Fundi, është një e vërtetë e padiskutueshme, që ai dallohet ndër ne të gjithë për origjinalitet në muzikë. Kë-

ngët, apo koncertet e kompozuara nga ai, kanë fituar gjithnjë në konkurset tona të shkollës.

— Ehu, edhe unë do të fitoja, — u hodh një nxënës tjetër, — nëqoftëse do të kisha marrë pakëz mundim të imitoja Mendelsonin, Moxartin, apo Beethovenin. . .

— Më falni, ju lutem, — e ndërpreu doktor Besimi, një burrë rreth të pesëdhjetave, me flokë pothuajse të zbardhur e me syze nga ato të miopëve. — Lejomëni, miku im i shtrenjtë, t'ju bëj këtë mbrëmje edhe unë një dhuratë jo të zakonshme, që mbase s'do të më vinte ndërmend t'ju bëja, në se kjo ngjarje, që po më shohin sytë, s'do të qe bërë shkak. Pra, dua t'ju dhuroj një tregim. . .

Ai heshti një çast dhe u hodhi një vështrim të vëmendshëm të ftuarve.

Fjalët e çuditshme të mjekut ngjallën papritur pëshpëritje të shumta e zhurmë.

«Dy muaj më parë, unë kam qenë shkencëtari i dëgjuar F. Galton. Po, po, mos qeshni, jua them këtë me bindje të thellë. Atë ditë bënte nxehtë dhe unë e ndjeja veten shumë të lodhur. Kisha dhjetë net që flija mbas orës dymbëdhjetë të natës. Më duhej të përfundoja një referat shkencor psikiatrik. Qeshë shtrirë në divan e nuk doja të mendoja për asgjë. Po në ka gjë më të vështirë në raste të tilla, është të mos mendosh. Problemi i ekzaminimit të sferës së të menduarit të të sëmurëve psiqikë, më kishte munduar prej kohësh. Veç bisedës me të sëmurin, kërkoja të gjeja edhe ndonjë mënyrë tjetër praktike. Befas më lindi një ide e shkëlqyer. «Po mirë, — thashë, — nëqoftëse te njerëzit normalë përgjigja ndaj pyetjeve jepet pas 1,8 — 2,2 sekondash, te njerëzit me çrregullime psiqike ç'kohë do të duhej, vallë?» «Një ide gjeniale, e mrekullueshme», — thashë i ekzaltuar e me një frymë e shkrova, sikur të kisha frikë se, do të harroja. Po një dyshim më mundonte, aq sa s'më lejonte t'i gëzohesha zbulimit tim. Më dukej se dikur kisha dëgjuar për këtë, apo ndoshta kisha lexuar diku, po, për fat të keq, asgjë s'më vinte ndërmend me saktësi. Po ndoshta ishte vetëm një për-

shtypje e gabuar. «Mbase asgjëkundi s'kam lexuar në lidhje me një eksperiment të tillë asociativ» (kështu e mbiqajta), thosha me vete. Sidoqoftë, s'guxoja t'ua bëja të ditur kolegëve të mi. Fillova me pasion të madh një sërë eksperimentesh me të sëmuret e mi psiqikë e çdo ditë vargu i konkluzioneve zgjatej. Vendosa të lexoj më shumë për shpjegimin shkencor të eksperimenteve të mia e pastaj të konkludoja. Një javë rresht flija a s'flija katër orë gjumë. E së fundi, atë mëngjez të bukur gushti, tek shfletoja një libër, pashë të nënvizuar nga dora ime, tre vjet më parë, përmbajtjen e plotë të «zbulimit» tim, që në të vërtetë qe propozuar nga F. Galton dhe i eksperimentuar më 1906 nga Jungu. Besomëni, vëllezër. Më vinte të qeshja e të qaja. Të qeshja për pozitën qesharake në të cilën do të më vinte kjo harresë fiziologjike e një njeriu të lodhur jashtë mase dhe të qaja për këtë diziluzion të madh. Në konferencën vjetore të psikiatërve, tek mbaja një referat mbi fenomenin e të ashtuquajturës kriptomnezi, si rast tipik dhe të parë përmenda timin. Po, miq, një fenomen i tillë është i mirënjohur nga mjekët. Përktihimi shqip i kësaj shprehjeje do të thotë kujtesë e fshehur, apo e shtrembëruar. Gjatë këtij fenomeni dobësohet, apo zhduket ndryshimi midis ngjarjeve, që kanë ndodhur vërtet dhe atyre, që janë parë në ëndërr, lexuar ose dëgjuar, gjë që shpie në keqkuptime nga më të ndryshmet.

Është, pra, një gënjim i kujtesës, një harresë. Mund t'i ndodhë cilitdo dhe çdo moshe nga mbilodhja. Sidomos të vegjëlit një ëndërr mund ta interpretojë, më vonë, si një ngjarje të jetuar. Në të vërtetë, ngjarja s'ka ndodhur, ndonëse i vogli betohet me zjarr për të kundërtën. Fëmija i pafajshëm akuzohet si gënjeshtar. Një fëmijë ka lexuar diku dhe dikur një vjershë të bukur. Ajo e ka tërhequr shumë, vargjet e saj i përsërit mekanikisht dhe kështu kalon një kohë. Pas kësaj edhe fëmija bën një vjershë e ja, padashur, fut një varg, që s'është i tij, po ai s'është imitonjës, s'është fajtor për këtë.

Ti ecën i shkujdesur në rrugë. Befas dikush të rreh

me dashamirësi supin e të thotë: «Tungjatjeta, o Petrit!» dhe matet të të përqafojë, po në të vërtetë ti je Ardiani. Ti e vështron i çuditur e mbase i hutuar. Befas i panjohuri rreh ballin me shuplakë, duke u kujtuar për keqkuptimin. I turpëruar të kërkon falje. Pra, të ka pandehur për një të njohurin e tij, që s'e ka parë prej kohësh, andaj s'është fajtor. Po ndonjë spekulonjës, sidoqë të tillë te ne janë fare të pakët, le të mos gëzohet. Mjekësija, psikologjia, pedagogjia, eksperiencia, vetë jeta, janë gjykatës të rreptë për ata që «gabojnë» me ndërgjegje. Pra, Dritani s'është fajtor. Jo, s'është! Kemi disa arësye, kur e gjykojmë si të tillë. Ai është dalluar për origjinalitet në kompozimet e tij, pra, s'kishte arësye të imitonte. Me muzikën e tij origjinale, të bazuar në motive popullore shqiptare, ai është duartrokitur shpesh. Për të kompozuar këtë koncert u ngrit në mesnatë, duke patur frikë se mos i harronte ata tinguj të madhërishëm. Nuk mund të ngrihej dhe as që do të ngrihej spekulanti për këtë gjë.

Ai s'kish arsye të kopjonte një melodi të dëgjuar nga shokët e tij. Këtë pakujdesi s'do t'ja lejonte vetes as spekulanti më mendjepakët. Dritani nuk ka spekuluar. Koha vetë do ta vërtetojë një gjë të tillë, vetëm ajo!»

Mjeku u hodhi një vështrim dashamirës të gjithëve. Ai mbaroi tregimin e tij, po, për çudi askush nuk u ngrit të fliste. Të ftuarit vështronin të mahnitur mjekun, që në emër të shkencës, kish mbrojtur një të pafajshëm, një të ri të talentuar.

I VERBËRI I ERRËSIRËS

— Mësues, ju kujtuat se unë gënjeja, kur ju thashë se në mbrëmje nuk para shoh mirë. Unë s'kam gënjyer kurrë, më besoni. Në muzg nuk mund të shoh qartë si më parë. Në dritën e llambës e kam vështirë të lexoj. Yjet e hënën i shihja aq qartë, aq bukur... Lojën «Luftash» e kam dashur shumë. Po, që nga koha kur nuk shoh në muzg, s'kam lojtur më. Mbrëmjeve afrohem te dritarja, dëgjoj zërat e shokëve që lozin, vështroj jashtë e nuk dalloj asgjë, veç mjegullës. Babai thotë se, gjersa ditën shoh mirë, edhe natën duhet të shoh mirë. Thotë se jam ca frikacak e se frika më bën t'i shoh gjërat të turbullta; po unë s'kam frikë... — tha Artani i pikëlluar e sytë e zinj ju përlotën.

Mësues Shkëlzeni, të jepte përshtypjen se s'kishte dëgjuar gjë nga fjalët e fundit të Artanit. Qe pushtuar i tëri nga përfytyrimet e ngjarjeve të fundit. Po, po, atij i kujtohej mirë... Në dy marshime të kryera natën, Artani s'kish marrë pjesë, megjithëse e kishte porositur veçanërisht. Të nesërmen nxënësi diç kishte dashur t'i thoshte, po ai s'e pat afruar. Artani i qe hapur Zanës, shoqes së klasës, dhe ajo i kishte thënë mësues Shkëlzenit se shoku i bankës nuk shihte natën, dhe kjo gjë e kish penguar të shkonte në marshim. Po ai e pat ndërprerë, duke i thënë se të gjitha ishin justifikime e se Artani shihte si gjithë të tjerët... Po Zana ishte mjaft këmbëngulese dhe më në fund mësuesi qe detyruar të dëgjonte vetë nxënësin.

Dhe sa mirë kishte bërë! Përndryshe, distanca që kishte dashur të mbante përkohësisht ndaj tij, me qëllim që ta ndjente thellësisht gabimin, do të qe një veprim i nxituar... Ai i hodhi një vështrim dashamirës Artanit e i ledhatoi ëmbël flokët e dredhur, që i mbulonin ballin e dirsur.

— Mos u dëshpëro, Artan. Ne do të këshillohemi me mjekun e shpejt ke për të parë edhe në muzg.

— Faleminderit, mësues! — tha Artani e, kokulur, doli nga klasa.

* * *

... Tek dilnin nga laboratorit, mësuesi u tha të gjithëve për marshimin që do të bënin së shpejti...

— Marshimin le ta udhëheqë Artani, — guxoi të tallej Mirashi.

Të tjerët e panë me inat Mirashin.

Artani u pushtua nga një pikëllim i patreguar...

Po mësuesi ju lut Artanit që të vinte në marshim duke i thënë se e kuptonte gjendjen e tij, se kjo do të qe një orvatje e vështirë për të, po...

* * *

Ajo mbrëmje qe e vrenjtur. Hëna pesëmbëdhjetëshe zbulonte herë-herë fytyrën rrumbullake e të ndritshme midis reve të dendura, që përshkonin me shpejtësi të guditshme qiellin.

Nxënësit ecnin në heshtje njëri pas tjetrit në një shteg që gjarpëronte midis së përpjetës së lodhshme.

Në krye dilte herë një nxënës e herë një tjetër.

— Tani le të udhëheqë Artani, — thirri mësuesi me zë të lartë, aq sa të dëgjonin të gjithë.

Nxënësi u kthye nga ai dhe e vështroi i drojtur.

— Mësues, unë ...

— Do të jem pranë teje, Artan, ecë pa frikë ...

«I verbëri i errësirës», u vu në krye të kolonës.

Me shkopin që mbante në njërën dorë, zgjidhte me kujdes vendin dhe hidhte çdo çap me mundim ...

— Përse ecim kaq ngadalë? — pyeti njëri nga nxënësit.

— Shumë ngadalë! — shtoi një tjetër.

— Artani s'para sheh mirë në mbrëmje. Çudi!.

Befas, mësuesi hapi duart, duke u zënë rrugën atyre që vinin pas. Fëmijët e ngulën vështrimin te ai, pa kuptuar gjësendi.

— Qetësi, nxënës! Pa shihni shokun tuaj, tani ai nuk sheh. Çdo gjë për të, është sterrë e zezë. E, megjithatë, ai udhëheq...

Vështrimi i mallëngjyer i të gjithëve që ngulur në siluetën gjysmë të ndriçuar nga rrezet e zbeta të hënës, siluetën me duar të lëshuara, drejt përpara vetes, me këmbë pak të hapura, që largohej dalëngadalë në terrin e natës.

* * *

Mjeku i bëri Artanit pyetje të ndryshme e, fill pas tyre, një kontroll të imët.

Më në fund ai i buzëqeshi ëmbël.

— S'ke asgjë për t'u shqetësuar. Një bar me pika do të të kthejë sërish pamjen e ti do të shijosh prapë shëttjet e mbrëmjes plot yje e hënë, do të lozësh me shokët e tu lojën, që aq shumë të pëlqen dhe do të lexosh prapë qartë në dritën e llambës elektrike.

Vështrimi i qeshur i okulistit ndeshi në vështrimin pyetës të të jatit.

— Oh, jo, jo, nuk kam harruar, do t'jua tregoj natyrën e kësaj sëmundjeje. E pra... Fëmija vuan nga i ashtuquajturi «verbim i pulave», apo «hemeralopia».

— Verbim i pulave! — thirri i habitur i ati, e të dy, atë e bir, shikuan njëri tjetrin në sy.

Mjeku qeshi lehtë.

— Te njerëz të kapur nga kjo sëmundje haset një fe-



nomen i ngjashëm me shikimin natyror të pulave, të cilat ditën shohin për mrekulli, po, sapo fillon të ngryset, mprehtësija e pamjes ulet aq shumë!. Për një kohë të gjatë, për shekuj të tërë, natyra e kësaj sëmudjeje mbeti e panjohur. Njerëz të tillë qenë vërtet fatkeqë, miku im... E pra, të mos shijosh bukuritë e mahnitshme të mbrëmjeve, t'i shohësh sendet tërë jetën të veshura nga një perde e hollë tymi e mjegulle, të detyrohesh të mbyllesh brënda, sapo fillon të ngryset, a nuk është kjo një fatkeqësi? Dhe vetëm me zbulimin e vitaminave u bë e mundur të zbulohet edhe shkaku i këtij verbimi të çuditshëm... U bë e qartë, më në fund, se njerëz të tillë vuanin nga një ulje e konsiderueshme e vitaminës A, që ndryshe quhet vitamina e rritjes dhe e të pamit. Mungesa e saj vonon rritjen e fëmijëve dhe u keqson së tepërmi pamjen. Tipike janë edhe ndryshimet në lëkurë, sepse vitamina A mbron epitelin e lëkurës nga dëmtimi. Kur mungon ajo, lëkura ashpërsohet, thahet e shpesh rripet. Pamja e saj është karakteristike. Duket sikur është e pudrosur. Te njerëz të tillë flokët kanë prirje të bien më shpejt, sidomos në moshë madhore...

Nëqoftëse më pyesni se ku gjenden burimet kryesore të kësaj vitamine, unë do t'ju përgjigjesha: te mëlçia e zezë e kafshëve, te gjalpi, qumështi, e verdha e vezës, te djathi i yndyrtë, te karrotat, domatet, qepët, spinaqi, te thanat, kajsitë, pjeshkët e te mjaftë prodhime të tjera...

— Ju faleminderit, shoku doktor, ju jemi mirënjohës. S'do t'ju harrojmë kurrë.

— Është detyra jonë dhe juaja, shok, t'i zbulojmë së bashku e t'u vimë në ndihmë fëmijëve tanë. Askush më shumë se ju, nuk do të qe në gjendje t'i zbulonte që në fillim sëmudje të tilla; mjafton të mendoni një çast se, pas çdo përparimi të dobët, pas çdo sjellje arogante, pas çdo ndryshimi në psiqikën e të voglit, ndoshta fshihet ndonjë sëmudje...

Kaluan gjashtë muaj. Një mbrëmje, tek shkonte në sheshin e madh të fshatit, vëmëndjen e mësuesit e tërhoqën të thirrurat e forta, të çiltëra e gazmore të nxënësve të tij, të cilat gjithmonë i ngjallnin në zëmër një ndjenjë të ëmbël e të ngrohtë. Tek afrohej, u kujdes të mos u binte në sy që në fillim.

— Shkëlqimi u zu rob i gjallë! — kumboi befas i fuqishëm zëri i kapitenit të vogël, Artanit.

Fill pas kësaj, sheshi i vogël oshëtiu nga thirrjet gazmore të fitimtarëve. «Robërit armiq» detyroheshin të kalonin përpara ushtrisë së kapiten Artanit, të rresh-tuar krah njëri-tjetrit, dhe çarmatoseshin.

Padashur, mësuesit i erdhi për të qeshur, kur pa fitimtarët tek ecnin rëndë-rëndë, me gjokset e nxjerra përpara e kokën lart, sikur të paskeshin fituar betejën më të madhe të kohërave.

Sakaq partizanët e vegjël rrethuan Artanin e brohoritën plot gaz e hare për lavdinë e kapitenit symprehtë, shikimit të të cilit, në betejën e asaj nate, s'kish mundur t'i shpëtonte as Shkëlqimi i vogël, që qe fshehur me mjeshtëri në një stivë drush.

— Oh, mësuesi! — thirri Artani, duke u shkëputur me vrap nga turma e të vegjëlve që e rrethonin.

— E fituat betejën sonte?

— Po, mësues! Është e dhjeta që fitojmë radhazi.

— Oh, një satelit, një satelit! — thirri me tërë fuqinë një vogëlush aty pranë, duke treguar me gisht një pikë të shkëlqyer në kupën gjysmë të ndriçuar të qiellit të mbrëmjes.

— Oh, ja tek është, ja tek është, e shikoni mësues? — u hodh Artani, duke treguar edhe ai me gisht pikën e shndritshme.

Po mësuesi nuk ngriti kokën drejt kupës blu. E kishte tërhequr më shumë vështrimi i ngazëllyer i syve të çiltër e të kaltër të të «verbërit» të dikurshëm, tek ndiqte plot gaz lëvizjen e asaj pike të shndritshme, midis mijëra pikave të tjera të shndritshme, që ishin yje.

ZH G Ë N J I M I

Inxhinjer Agronit e bashkëshortes së tij, njëmbëdhjetë vjet më parë, u lindi një djalë. Dani e quajtën. I vogli i tyre filloi të hedhë shtat e të zbukurohet. Në moshën pesëvjeçare qe një fëmijë i shëndetshëm, topolak, gazmor, i shkathët e i zgjuar, veti këto që e bënë Danin një fëmijë të këndshëm.

— Fëmijën e keni shumë të zgjuar! — u tha një ditë profesor Arbëni, një fqinji i tyre.

— I jashtëzakonshëm! — u përgjegj me një frymë Vera, e ëma, me një ngazëllim të papërshekruar. — Do të bëhet i madh.

Profesori qeshi. «Sido që të jetë, — mendoi ai, — prindi ka të drejtë ta përfytyrojë të ardhmen e fëmijës me ngjyrat më të bukura».

— Më thanë se kini vendosur t'i mësoni shkrim e këndim të voglit tuaj — u kujtua profesori.

— Posi, posi! Shënjat e para janë shumë premtunjëse. Do të mësojë shumë shpejt...

— Mirë bëni. Një gjë e tillë s'ka për ta rënduar Danin po, sidoqoftë, mos u nxitoni t'ja mësoni përnjëherësh. Pak e nga pak... Po, a është e vërtetë se keni ndërmend t'i mësoni Danit një gjuhë të huaj, shahun, vjersha të gjata, se...

— Po, po, ju kanë thënë të vërtetën, — pohoi Vera me një ton krenar.

— Besa, kjo më duket e tepërt. Të mësojë diçka të thjeshtë, qoftë edhe të shkruajë në këtë moshë, s'ka asgjë të keqe, raste të tilla janë të shpeshta, po s'e kuptoj dot ç'ju shtyn të tejkaloni caqet e asaj, që është e natyrshme për këtë moshë. Të vegjëlit duhen ruajtur nga stërmundimi, nga sforcimet e jashtëzakonshme. Duke u rritur dalëngadalë shtohen edhe kërkesat, edhe ngarke... Përse nxitoni kaq shumë? Është ende i vogël.

— I vogël?! — e ndërpreu ajo, pak e habitur nga arësyetimi i profesorit. — E dini se vogëlushja Deni, në moshën shtatëvjeçare, zotëronte tri gjuhë, luante në piano, shah, recitonte poema të gjata, shkruante, ehu... e çfarë s'bënte?! Po Moxarti?..

Vera numëroi pas këtij një sërë emra njerëzish të shquar, që qenë dalluar që në moshë të hershme për talentin e tyre...

— Është e vërtetë! Të gjithë shkëlqyen në moshë të hershme, po fundi i shumicës së tyre?! Ata do të kishin rrojtur ca më shumë, do të kishin krijuar edhe vepra të tjera të pavdekshme, nëqoftëse prindërit do të qenë më të duruar... Keni qënë ndonjëherë në ndonjë garë vrapimi?

Vera pohoi me kokë.

— Në garat e vrapimeve të gjata, asnjëherë nuk e pret shiritin i pari, ai që e nis vrullshëm... Forcat duhen matur me kujdes. Çdo gjë në kohën e vet...

— Ne jemi të vendosur, shoku Arben. Dani im është i talentuar. Fëmijë të tillë s'kanë njohur dhe... as që do të njohin, normat tuaja pedagogjike...

— Mjekësore, — korigjoi profesori... — Një këshillë të tillë na e japin në radhë të parë mjekët...

— Mjekët?! — Ajo qeshi nën buzë. — Po të dilnin të vërteta të gjitha sa thonë doktorët, ehu... Megjithatë, koha le të na gjykojë.

— Po, koha! Megjithatë, nëqoftëse ka bast, që do të dëshiroja të humbisja, është ky i sotmi, Vera! — u përgjegj profesori duke qeshur.

Dani tanimë qe bërë një djalë shumë i këndshëm për vizitorët e miqtë e kryeinxhinierit.

Kur djali mbushi 8 vjeç, prindërit vendosën ta festonin. Kishin ftuar të rritur dhe vërsnikë të Danit. Me këta të fundit e ëma e kishte ndaluar të shoqërohej, duke menduar se nga moshatarët s'kishte ç'të përfitonte. (Ç'do t'i mësonin ata? A kishte ndonjë gjë që ata ta dinin e ai, Dani i saj, të mos e dinte?!)

Nëqoftëse ajo ftoi për herë të parë shokët e shoqet e klasës, këtë s'e bëri rastësisht...

Të rriturit do të mund të shihnin me sy ndryshimin e madh midis të voglit të saj e vërsnikëve. Ç'provë më të madhe, bindëse, do të gjente për të treguar se cili qe Dani, «shkencëtari» i saj i ardhshëm?

— Oh, po sikur të bënim një konkurs të vogël?! — u drejtua Vera nga fëmijët, sikur ky mendim t'i vinte në kokë ashtu, papritur.

Të vegjëlit pranuan me qejf. Atëhere ajo ju lut të pranishmëve t'u drejtonin pyetje të çfarëdoshme fëmijëve.

Ç'ngadhnjim i madh! Dani s'i la të hapnin gojë fëmijët e tjerë. Çdo pyetjeje, që kalonte caqet e dijeve të moshës së tyre, ai i përgjigjej shpejt dhe saktë.

Vështrimi i ngazëllyer dhe triumfues i Verës u kryqëzua një çast me vështrimin e mendueshëm e të qetë të profesor Arbenit. Vështrimi i saj dukej sikur donte të thoshte:

«E, profesor? Po tani? E pranoni, më në fund, se betejën e humbët? Po t'ju dëgjoja ju që para tre vjetësh, Dani s'do të ishte ky, që shihni sot!

Vështrimi i qetë i profesorit fliste ndryshe.

«Uroj që vogëlushi juaj ta kalojë me sukses këtë provë të vështirë, të panatyrshme! Ngadhnjimi i sotëm mund të të hapë ca më shumë oreksin. Ndoshta do ta ngarkoni me një sërë detyrash të reja, të vështira, dhe atëhere tragjedia është e pashmangshme! Zhgënjimi do të jetë i tillë, që do t'ju bëjë të vuani tërë jetën».

Kur të ftuarit duartrokisnin Danin, ajo e puthi fort.

— Të lumtë, o ylli im i vogël! Dijetari i mamit!

— Lermë!— ju përgjegj Dani me fodullëk. — S'jam më i vogël që më puth kështu...

Ajo u skuq lehtë e nënqeshi, pa ditur ç'të thotë. Kohët e fundit Dani po e tepronte! «Sidoqoftë, s'duhet t'ja vë re, — mendoj. — Si çdo fëmijë i talentuar, edhe ai ka teket e lij...»

* * *

Dani u bë shpejt i njohur. Kudo e tregonin me gisht si një fëmijë të jashtëzakonshëm, i cili, në moshën pesë-vjeçare, kishte mësuar të shkruante e të lexonte, të recitonte përmendësh vjersha të gjata, të luante shah, kishte fituar elementet e para të një gjuhe të huaj, e të tjera.

Mësuesja e klasës IV e pyeste rrallë, e ngrinte vetëm në ndonjë rast të veçantë, atëhere kur nxënësit e tjerë s'e kënaqnin me përgjigjet e tyre.


Një herë (kjo kishte ndodhur aty nga fundi i vitit), mësuesja nuk u kënaq nga përgjigjja e Danit. Ai, për çudi, atë ditë dukej i lodhur dhe ishte ngatërruar. Ajo e kishte vlerësuar me notën tetë. Dani s'e kishte përmbajtur veten. Kishte qarë me të madhe.

— Edhe dhjeta është pak për të!— i kishte thënë Vera atë pasdite mësueses e, kokëlart, kishte dalë nga salla, duke përplasur fort derën.

* * *

Në klasën e pestë, Dani filloi të bjerë gjithnjë e më shumë në mësim, ndonëse kohën e studimit s'e kishte paksuar.

Netve të dimrit nëna i qëndronte pranë tryezës së studimit e diç qëndiste. Herëpashere, vështrimi i trish-



tuar i saj ngulitej në fytyrën e tërhequr e delikate të vogëlushit.

«Dani im! Ç'po ngjet kështu me ty! — mendonte me pikëllim. — Përse je zbehur kaq? Ç'e keqe të mori gjumin e të bën të përpëlitesh në shtrat netve të gjata? Dikur flije si qengj... Ishe aq i urtë, aq i dashur, aq i butë! Si një qengj! Ndryshove pa të kuptuar!»

Ajo vinte re si djali rrudhoste fytyrën nga dhembja. Ç'të ishte, vallë, ajo dhembje, që si kaskë hekuri kokën ja shtrëngonte?

«Një 11 vjeçar nevrastenik!?... Im bir nevrastenik? ...Një i mbilodhur... që u dashka të çlodhet, të ripërtërihet, një fëmijë të ripërtërihet!?.»

— Oh, sa u lodha, nënë! Sa më zicën koka!.. Asgjë s'më hyn në tru. Nënë, nuk e di, po kohët e fundit, pa e kuptuar as vetë, më pushton një frikë e pashpjeguar... Nuk e di nga kush trembem, po kam frikë, frikë, nënë.

— Ngrehu, Dani, eja të shëtisim!—i foli ajo e shqetësuar, duke lënë mënjanë qëndizmen... — Sonte është natë e bukur...

Pas pak ai i zgjati dorën dhe ajo ndjeu tkurrjen nerveze, ritmike, të gishtave të tij të vegjël.

Të dy, ëmë e bir, dolën në bulevard. Era e freskët, që frynte atë mbrëmje, shushurima e ëmbël e fletëve, qielli me hënë e plot yje, rrjedhja e ngadalshme e Lanës e qetësuan të voglin.

— Tani e ndjej veten më mirë. Vërtet do ta lëshkollën këtë vit? — pyeti ai, duke i ngulur vështrimin e lodhur.

— Po, Dani. Do ta lësh... për t'u çlodhur.

Atë çast, bri tyre, kaluan një grup vërsnikësh lë Danit! Me shpata të vogla prej druri, me të thirrura të hareshme, ndiqnin njëri tjetrin. Njëri syresh u erdhi rrotull Verës e Danit disa herë, për të shpëtuar nga ndjekja e një «kalorësi» të shkathët. Sa herë që vogëlu-

shi i shpëtonte goditjes së «shpatës së kalorësit», qesh-te gëzueshëm...

Pastaj dy «kalorësit shpatarakë» zbritën rrëmbimthi tatëpjetë brigjeve të Lanës, për t'u bashkuar me të tjerët.

Ajo i ndoqi një copë herë me sy e befaz ju duk sikur një forcë e padukshme ja mbërtheu fort zemrën, aq sa ndjeu t'i dhembte.

Danin e kishte ndarë prej kohësh nga ajo shoqëri e gëzuar, për ta shpënë gabimisht në një rrugë të natyrshme.

«Ai duhet të kthehet prapë te ata, po... s'ka për të qënë më kurrë me ta... në një klasë... Do t'i bashkojnë vetëm lodrat pasditeve...» — mendoi e trishtuar nëna.

Atë çast ju duk sikur dëgjoi fjalët e profesorit:

«Asnjëherë nuk e prek shiritin i pari ai që e nis vrullshëm. Forcat duhen peshuar, duhen matur mirë», kurse Dani i vogël s'kishte mundur as të mbaronte «garën», s'kishte arritur në «finish». «Zhgënjim të madh si ky, s'kam njohur kurrë!» — mendoi.

Nga larg vinte jehona e zërave të gëzuar të «kalorësve shpatarakë», që i përngjiste një melodie të bukur çlodhëse.

«I PËRGJUMURI» (1)

Në dhomën 16-të, ku flinte udhëheqës Shkëlqimi, u zhduk papritur njëri nga koleksionet më të çmuara të fluturave, te i cili fëmijët kishin varur shpresat më të mëdha për të konkuruar me sukses. Si reja e zezë, që çfaqet befas në horizontin e largët e të kthjellët të një dite pranvere, u përhap lajmi i kësaj humbjeje. Mbase, gjatë lojrave të gëzuara, edhe harronin, po sërish e papritura bëhej strumbullari rreth të cilit vërtiteshin bisdat e fëmijëve.

- E dinin se fitonim, ndaj na e muarën!
- E kanë flakur në greminë koleksionin tonë!
- Sa të bukura që ishin ato flutura!
- Po sikur ta kenë hedhur vërtet në greminë?
- Edhe atje do ta gjejmë!
- Sonte jemi roje unë dhe Iliri. Udhëheqësit kanë mbledhje.
- Edhe unë do të jem roje!
- Edhe unë!..

* * *

Kishte kaluar gati një orë që rojet e vogla prisnin plot ankth. Befas dëgjuan zhurmën e mbytur të çapeve, që shkelnin mbi qilimin e gjatë të koridorit. Instinktivisht, të vegjëlit u ngritën e mbajtën vesh.

I panjohuri filloi të ecë prapë, hapat po ndjeheshin më afër.

«Po vjen!» — menduan të gjithë dhe një e dridhur u përshkoi shtatin.

Në gjysmerrësirën e dhomës, vështrimi i ethshëm u përqëndrua në imazhin e turbullt të dorëzës.

Në dhomë hyri një siluetë e vogël.

Fëmija mori frymë disi më e lehtësuar.

«Qenka i vogël! Më i shkurtër se unë!» — mendoi komandanti.

I porsaardhuri, që atyre ju duk fare i qetë, përshkoi koridoret e ngushta midis shtretërve.

Komandanti i kompanisë brofi nga shtrati dhe ndezi dritën. Po kjo nuk e shqetsoi vërsnikun.

Ndërkohë, Iliri i qe afruar fëmijës.

— Hej, ç'kërkon këtu? — i thirri.

Sytë e fëmijës së kompanisë së 18-të, të ngulitur diku në hapësirën e dhomës, ju dukën të humbur e të nemitur, sikur të flinte me sy hapur.

Fëmija s'u përgjegj.

— More, po dëgjon ç'të thashë? Hm, është hutuar sa s'ka ku të vejë!

— Se është zënë me presh në duar!

— Përgjigju! — i thirri komandanti me ton të ashpër dhe i mbërtheu fort krahun.

Fëmija u drodh lehtë e, vështroi përreth i habitur.

— Ku jam? Kush jeni ju, — pyeti me frikë, duke përpëlitur sytë e vegjël.

— Hej, sa qesharak! Po e lot pjesën që ç'ke me të!

— Vjen në dhomë si pa gjë të keq e ja tani të thotë «Ku jam? Kush jeni ju?» E ne të kërkonim prej ditësh.

— Doje të merrje koleksionin tjetër, mbase, që të fitonit ju!... Ç'njeri!..

— Ç'thoni? — kundërshtoi fëmija. — Nuk e di si erdha gjer këtu! Nuk e di! Besomëni.

— Artan! U thuaj udhëheqësve të vijnë!

— Ç'keni ndërmend të bëni me mua? Lëshomëni! Kam hyrë pa dashje! — thirri fëmija, duke u përpjekur t'u shpëtojë fëmijëve, që e rrethonin.

* * *

— Si? Ti qenke, Fatos? Po ç'kërkoje këtu? Mos ishe në banjë dhe padashur ngatërrove dhomën? — i tha udhëheqësi i tij.

— Jo, udhëheqës! S'e kuptoj dot si erdha këtu! Dikush nga këta më thirri fort, u zgjova i trembur dhe e pashë veten në këtë dhomë... i rrethuar nga këta!

— Gënjen! — thirri Artani. — Nuk flije! Sytë i kishe të hapur.

— Mbase, po më dukej se flija... S'më vinte ndër-mend se qeshë ngritur... Jo! Unë s'marr vesh fare ç'ndodhi me mua!..

* * *

— Jo, Shkëlqim! Nuk duhet të nxitohemi! Fatosi justifikohet në një mënyrë të tillë, që të bën me gjithë mend të dyshosh! Përgjigja e tij është e ngatërruar, e paargumentuar. Po, pa pyetmëni mua! Ai është fëmijë e mrekullueshme. Ai nuk do të arrinte kurrë gjer atje! Mos harroni se ai mohoi ngatërrimin e dhomës, që është një argument i fortë mbrojtës për të.

— Ç'mendon? Ta mbyllim çështjen? Po fëmijët çdo të thonë?

— Të bisedojmë edhe me ata. T'u lëmë të kuptojnë se duhet pritur gjersa të gjendet fajtori i vërtetë. Pas-taj janë disa të dhëna që të bëjnë të dyshosh për një gjendje të veçantë të gjumit të tij.

— Mos do të thuash se Fatosi është një i sëmurë? Sido që të jetë, bisedo me doktorin tonë të kampit. Mbase të ndihmon.

* * *

Pas koleksionit të parë, brenda një jave, Tani i vogël mblodhi një të dytë, po aq të bukur.

— Pa shihni ç'koleksion kam mbledhur! — u tha pas dhjetë ditësh shokëve. Desh të shtojë se kishte ndër-mend t'ja dhuronte shkollës, po udhëheqësi, shokët, tek

panë ato flutura të rralla, të ngulura me gjilpërë në kartonin e butë të kornizës, s'e lanë të hapë gojë.

— Të lumtë, Tani, botanisti ynë! Aha, tani kompanisë s'ja del njeri! Një urra të fortë për Tanin tonë!

— Urra! — u përgjegjën me gaz fëmijët e s'pushonin së thirruri e së përqafuari Tanin.

Ai buzëqeshte i hutuar. Një herë, kur ishte më i vogël, kishte mpleksur padashur topin e leshtë të trikos e i kujtohet sa qenë munduar ta shpleksnin, sa qe bërë nervoze e lodhur e shkreta gjyshe. Edhe tani mendimet i qenë mpleksur, i qenë bërë një lëmsh i ngatërruar, të cilit s'ja gjente fillin... Nga njëra anë i kujtohej letra që i kishte dërguar mësueses me premtimin se kishte për t'u kthyer duarplot me një koleksion të rrallë, dhe në anën tjetër entuziazmi i papërshekruar i shokëve, i udhëheqësit.

* * *

Atë natë, Arbeni kishte rënë të flerë më vonë se zakonisht. Tek përpëlitej i shqetsuar në shtrat, se gjumi s'e zinte, dikush zbriti nga shtrati.

«Mbase ndonjë nga fëmijët shkon në banjë».

— Ti je, Sokol? — pyeti, kur silueta i kaloi pranë. Po silueta s'u përgjegj.

— Cili je?..

Sërish heshtje. Mos vallë ishte Fatosi? Kur fëmija hapi derën, rrezet e dobëta të koridorit ndriçuan siluetën.

«Mbase është ngritur pa vetëdije. Mbase është një nga ngritjet e tij të zakonshme, — mendoi dhe me një kërcim të shkathët u hodh nga «kati i dytë» i shtratit.

* * *

Nata qe e bukur. Qielli qe mbushur plot me yje të ndriçme. Ai ndjeu flladin e ftohtë të natës malore. Si-

lueta e vogël, gjysmë e ndriçuar nga rrezet e zbeta të hënës, zbriti nxitimthi shkallët e pallatit pesëkatësh e përshkoi fushën e basketbollit.

Arbeni, që e kishte ndjekur, duke u përpjekur të mos bjerë në sy, u mbështet në shkallën suedeze, i lodhur dhe i pushtuar nga dridhja rrëqethëse.

Vështrimin e çakëritur e kishte mbërthyer ngultas te silueta, që ndërkohë, me kërcim të shkathët e të sigurtë, që hedhur mbi traun e ekuilibrit.

«Ç'ka ndërmend të bëjë? Kërkon të kalojë traun? Është e pamundur! S'e ka kaluar qoftë edhe një herë. Veç kësaj tani është natë...»

Silueta bëri tre hapa përpara, u ndal dhe sytë e zinj u kthyen për nga ndërtesa, që vezullonte nga ndriçime të ëmbla.

Rrezet e zbeta të hënës u derdhën si shi i argjentë mbi atë fytyrë të zbetë e të tërhequr dhe u dhanë syve të përgjumur një ndriçim të çuditshëm, sikur dy bebëzat t'i qenë ngjyer me fosfor të bardhë.

Silueta filloi sërish të ecë në traun e ngushtë, me kokën e kthyer anash nga ndërtesa, sikur të donte t'u tregonte shokëve, që ndoshta i faniteshin në mugëtirë, se ç'që në gjendje të bëjë...


«Sa keq që nuk lajmërova doktorin! Apo s'më është lutur! Sa mirë që s'paska rënë ende të flerë!» — mendoi duke gzykuar nga drita e ndezur e dhomës së mjekut.

* * *

Kur u kthyen, Fatosi që zhdukur. Të dy ndjenë rrahje të fuqishme e të shpeshta zemre. Vështrime të zymta u kryqëzuan, si të donin të zgjidhnin enigmën.

— Nuk duhej ta kishe braktisur, Arben. Të më kishe lajmëruar para se të vije këtu... Po sikur të ketë vajtur në greminë?...

— Jo, more! — thirri i tronditur Arbeni dhe, si i çakërdisur, filloi të vrapojë drejtë shkëlqimit të zbetë, që si gjuhë gjigante ngrihej nga honi i kampit. Gurë, trungje, shilarëse i dilnin përpara, po tani ai



thuaje nuk i përfillte fare. Tërë qenja e tij ishte përqëndruar te silueta. Leshrat e shpupuritur herë-herë i binin mbi sy dhe ai, pa vetëdije, i ngrinte me një lëvizje të nervozuar.

E ndanin njëqind metra, kur lëshoi një thirrje të ngjethshme:

— Ai është, Fatosi, ai vetë!

— Kujdes! Nuk duhet zgjuar! Kjo do të që e rrezikshme. Vetëm tani e kuptoi se s'kishte vrapuar i vetëm.

Fatosi, si një statujë e errët bronxi, kishte qëndruar mbi shkëmbin e thepisur, me duart e zgjatura për nga qyteti, që digjej ëmbël në mijëra dritëza.

Arbeni u afrua plot ankth, duke u lëkundur, sikur toka t'i dridhej nën këmbë. Kur s'e ndanin veçse dy hapa, u hodh mbi siluetën dhe e rroku në krah.

Flladi i ftohtë e bëri të dridhet. U kujtua të heqë xhaketën e të mbulojë trupin thuaje lakuriq të të përgjumurit.

Befas Fatosi u përmend.

— Ku jam? Ç'bëj këtu? — pyeti i hutuar.

— Eja, Fatos, eja të shkojmë! — i tha Arbeni, duke i hedhur me dhemshuri dorën mbi sup.

«Nesër, fëmija i gjorë s'ka për të kujtuar gjë. Mbase kurrë s'do t'i shkojë ndërmend se një natë me hënë kishte hipur mbi një shkëmb të thepisur, ku edhe sorkadhja e ka të vështirë të qëndrojë dhe të sodisë Tiranën e vezullimeve. Një çap më tutje dhe...» mendoi mjeku. —
— Jo, Arben! Ekuilibri i çuditshëm s'ka për ta ndihmuar gjithnjë!»

Tri siluetat u larguan ngadalë në drejtim të ndërtesës, që flinte thellësisht atë natë të bukur qershori. Dhe vetëm llambat e tarracës, «dëshmitarë të heshtur e të vetmuar», vazhdonin të dridheshin...

* * *

Atë mbasdite, të mbledhur në hijen e pishave, fëmijët prisnin të heshtur dhe të pushtuar nga ankthi i

kureshtjes fjalën e mjekut. Ç'gjë, vallë, e kishte detyruar atë, t'u flasë atyre, fëmijëve të kampit?..

— Gjer më sot, dyshimet tuaja për koleksionin binin mbi një shok të mirë, mbi një të sëmurë të vogël, që pa vetëdije, në gjendje gjumi, hyri një natë në dhomën tuaj. E pra, ai është i pafajshëm, — filloi të flasë mjeku. — Dyshimet tuaja e shqetësuan aq shumë Fatosin, sa, brenda tri netve të fundit, është ngritur dy herë e mbase e mbrëmshmja ka qenë për të ajo më e rrezikshmja. Dikush vazhdon të fshihet ende prapa sëmundjes së tij, po s'bën mirë.

Njëri nga fëmijët ngashëreu. Artanit i qenë mbushur sytë me lot e dridhej i tëri.

— Çfarë ke? — pyeti i shqetsuar Shkëlqimi, duke u ulur pranë tij.

— Unë e kam marrë, unë e mora koleksionin, — foli i penduar fëmia, me trupin që i hidhej peshë nga ngashërimat. Në supe ndjente peshën e rëndë të gabimit, që ai s'do të vononte ta shlyente...

DALTONISTI I VOGEL

Në klasën e parë të degës së pikturës, atë vit shkollor kishte ardhur një nxënës i talentuar. Debutimi i tij në konkursin e pranimit kishte qenë i shkëlqyer, aq sa punimet e tjera të vërsnikëve i qenë dukur naive pedagog Gencit. Atij i erdhi keq që talente të tilla janë të detyruar të presin po aq vjet, gjer në diplomim, sa edhe ata... «mesatarët». Genci filloi të tregojë një kujdes të veçantë për Bardhylin dhe, në pamje të jashtme, të krijohej përshtypja sikur të tjerët s'ekzistojnë për të.


— Kur do të fillojmë të punojmë me ngjyra? — e kishte pyetur një ditë Bardhyli, me sytë që i shkëlqenin.

— Kaq shumë të pëlqen të pikturosh me ngjyra? Mbase mund të fillojmë edhe këtë javë!.. — tha pedagogu.

* * *

Tabloja «Betimi partizan» e piktorit të njohur V. M. qe e përkryer. Që në fillim të vitit shkollor, atë e kishin vendosur në hyrjen qendrore të shkollës dhe qe e pamundur të shkoje pranë saj e të mos ndjeje forcën e madhe shprehëse. Kur ishte dezurn, dhe koridori mbetej si i shkretë dhe i përgjumur, (ndërkohë nxënësit studjonin në sallën e madhe), ai humbiste i tëri duke adhuruar tablonë...

Ndërkohë, shokët kishin filluar të pikturonin, kurse ai, eh, s'ndodhej më në studjo. Jo! Ju duk një çast se



partizani i vogël simpatik i tablosë, me kokën e lidhur me fasha, që kuqëlonin, e ftoi të qëndronte pranë tij, të merrte pjesë edhe ai në atë betim solemn partizan...

Instinktivisht, pa ditur ç'bënte, ai filloi të skicojë. Një çast ju desh goma për të fshirë një linjë, që atij s'ju duk e arritur, dhe më kot e kërkoi një copë herë në tavoloc, në kavalet, në dysheme. Dhe vetëm pastaj (çudi e madhe sa shumë e kishte humbur mendjen!) ndjeu se diç mbante shtrënguar në dorën e majtë, që instinktivisht qe mbledhur e bërë grusht, tamam si grushtet e partizanëve. Ai vështroi grushtin e tij. Ç'tendosje e fuqishme e muskujve të vegjël të duarve dhe të ligamenteve të tyre! Çudi! Si s'e kish ndjerë atë shtrëngim të fortë? Madje, ai s'u kujtua t'i hapë gishtrinjtë edhe atëhere, kur, të shtrënguar fort pas pëllëmbës, i qenë djersitur dhe i shkaktonin një farë dhembjeje, po vështronte si i nemitur brazdat ndarëse të muskujve të tkurrur fort, të cilave ai kishte për t'u dhënë më shumë hije, më tepër kontrast, që ai shtrëngim të dilte në pah i fuqishëm, si vetë hakmarrja partizane.

Në çast pedagogu qëndroi pranë tablosë së tij. S'ja shqiste sytë. E vështronte ngultazi, duke u përpjekur të kuptojë sadopak mendimin e tij. Në fillim, ai vështtrim ju duk si i habitur Bardhyllit dhe i mbushur me një dyshim të tillë, si të mos u besonte syve. Më në fund duke psherëtitur thellë, me një ton të përmbajtur e inkurajonjës, i tha:

— Bukur, Bardhyl! Veçanërisht grushtet partizane janë skicuar mirë... Si fillim, s'është i keq...

Atë çast Bardhyli e ndjeu veten të pushtohej nga një ndjenjë e veçantë lumturie, të ngjashme me atë gjendje shpirtërore, që e zotëronte sa herë shëtiste në fidanishten e trëndafilave «të kuq». Një herë ai dhe motra e vogël, Drita, kishin ndihmuar t'ëmën, punonjëse në fidanishten e rritjes së luleve, për të mbledhur trëndafilë të kuq. Ai as që kishte dyshuar se do të mbledhte më shumë trëndafilë se e motra, që ishte pesë

vjeç më e vogël, po mezi kishte mundur të mbledhë gjysmën e saj. Pse i ndodhi kjo, këtë atëhere s'kishte qenë në gjendje ta kuptonte.

— Ti ke sy të mprehtë, Drita, — i kishte thënë së motrës dhe ajo ja dha të qeshurit, duke i treguar me gisht dy trëndafilë të vegjël të kuq të cilët ishin fare pranë tij, e megjithatë, ai s'kishte qenë në gjendje t'i dallonte.

— Sheh mendja e jo syri, — i kishte thënë ajo. — Po trëndafilët e bardhë, sa shpejt i mblodhe! Sa pas që më le... Kurse tani ti s'e ke mendjen... Kushedi se ç'bluan ajo koka jote!

Ai befasi u përmend, vështroi sërish tablonë, e buzëqeshi padashur. «Drita kishte të drejtë! — mendoi. — Vërtet që nganjëherë e humbas fare mendjen... Ah, jo, tani do të përqëndrohem i tëri në tablo...»

S'kishte pikë dyshimi që piktori V.M. i kishte dhënë një intensitet të fuqishëm së kuqes, e cila për të ishte në të vërtetë një tjetër ngjyrë, një e gjelbër e zbetë, me një nuancë të verdhë. Kështu e kishte njohur që në fëmijërinë e hershme atë ngjyrë, së cilës i thërrisnin «e kuqe», (dhe ai, padyshim, ashtu do ta quante «të kuqe») dhe kurrë s'do t'i vinte ndërmend se e perceptonte si një tjetër ngjyrë, që mund të ishte gjithçka, po jo e kuqe.

Për ta bërë sa më shprehëse e të fuqishme ngjyrën e tij të preferuar, ai përzjeu në tavoloc ngjyrën blu e të verdhë. Nga përzjerja fitoi ngjyrën e «kuqe» për sytë e tij, që në të vërtetë ishte e gjelbër me një nuancë gati të padukshme të verdhë, dhe me të filloi të ngjyrosë flamurin e kuq, të shpalosur mbi trupin e dëshmorit, fashat që kuqëlonin, të partizanëve të plagosur, yjet partizane, lulëkuqet, gjithçka të zjarrtë, gjithçka të kuqe.

Ai ishte thelluar aq shumë në tablo, sa nuk e ndjeu pedagogun kur u ndal për herë të dytë pranë tij. Po të kishte kthyer kokën, vështrimi i Bardhylit do të kish-të ndeshur në sytë e çakëritur të mësuesit, i cili po vris-

te aq shumë mendjen se ç'e kishte detyruar nxënësin e tij të talentuar të gabojë aq rëndë.

— Bardhyl, ç'bën kështu! Koregjo ngjyrën! Kur ju thashë të kopjoni tablonë në mënyrë krijuese, kjo s'do të thotë të arrini në teprime absurde, apo jo?..

— Po... unë... kështu e perceptoj, profesor, tablonë... Këto mbresa më la ajo mua.

— Mos e tepro! Gjithnjë perceptimi duhet të jetë logjik... i argumentuar. Kurse ti... ke arritur gjer në absurditete të papranueshme. Ngjyrën e kuqe e ke zëvendësuar me të gjelbrën... .

— S'është e mundur, profesor! — kundërshtoi nxënësi. — Përkundrazi, unë e kam theksuar më shumë të kuqen, se sa tabloja. Ka një intensitet të madh.

«Ke filluar të piqesh ca si shpejt,» — mendoi profesori, pa ja shqitur sytë.

— Pra, nuk sheh ndonjë ndryshim midis ngjyrës sate e asaj të tablosë? — pyeti ai.

— Ndryshime të vogla, profesor! E kuqja ime është më intensive... — thirri Bardhyli me një çiltërsi të tillë, sa që profesorit ju duk se po e vinin në lojë.

Prapa krahëve të tij dëgjoheshin zëra nxënësish, të qeshura të mbytura.

— Pra, dhe ju të tjerët jeni në një mendje me shokun tuaj? — ju drejtua pedagogu nxënësve, që tashmë kishin lënë punën e ndiqnin rrjedhën e kësaj të papriture të çuditshme. — Pra thoni se flamuri i Bardhylit është i kuq e jo i gjelbër, se yjet... lulëkuqet... .

— Të gjelbëra janë, — u hodhën disa syresh, duke ngritur supet, si për të shpjeguar se kjo gjë ishte e qartë si drita e diellit dhe se ky diskutim u dukej vërtet i habitshëm.

Ai u përkul mbi Bardhylin, që u tërhoq lehtë, disi i frikësuar nga zbetësia që kish pushtuar papritur pedagogun.

— Thuamë, pra, je i bindur se ngjyra jote është e kuqe dhe jo e gjelbër, siç e ke përdorur në të vërtetë?

— Është e kuqe, profesor, unë... s'kuptoj ç'kërkoni prej meje! Për mua është e kuqe.

— Kurse për mua është... është, për mua...

Befas pedagogu shtangu, sikur dikush ta kishte hipnotizuar.

— Pa dale, pa dale... — pëshpëriti me zë të ulët, si të fliste me vete: — Nuk duhet nxituar, jo, kurrë, jo, mbase, mbase...

Si i topitur, ai u ul në karrige dhe vështrimi i tij i çakëritur, u mbërthye mbi tablonë e V.M, pastaj mbi Bardhylin, mbi tablonë e tij... dhe, në këtë gjendje të çoroditur, ju duk se dalloi një kuadër tashmë të largët, tashmë gati të harruar...

Profesori i tij plak u kishte demonstruar, në një nga mësimet teorike, dy tablo të Pol Gogenit të riprodhuara nga dy piktorë daltonistë. Oh, çudi e madhe! I bëhej se dëgjonte zërin gati të shuar e të mekur të një njeriu që s'ish më:

«Vështrojini këto dy tablo të të madhit Pol Gogen! Vështrojini mirë. Lexoj habi në sytë tuaj. E pra, dy piktorët, që i kanë riprodhuar, kanë rënë padashur në një gabim të tillë. Janë fatkeqë të lindur dhe dhjetë herë të tillë, si piktorë që janë... Ju nuk mund të përfytyronit dot konfliktin e madh, që ka shkaktuar padashur një e metë e tillë serioze në të perceptuarit e ngjyrave reale. Rrallë ndodh që piktorët të vuajnë nga kjo e metë e mbase kjo ka për të shërbyer si shkas edhe për të harruar këtë të vërtetë... dhe atëhere ju, mësues të ardhshëm, jeni në rrezik të jepni gjykime të gabuara në vlerësimet e këtij ose atij nxënësi».

Befas mësuesi u përmend. Ai vështroi me dhembje flamurin e gjelbër, fashat e gjelbëra, yjet e gjelbëra, lulëkuqet (shumë syresh ai s'kish mundur t'i shquajë) dhe ndjeu rrëqethje në trup. Nxënësi i tij kishte lindur i verbër ndaj ngjyrës më të bukur, më të zjarrtë në botë dhe mbase që atë çast do të që i detyruar të braktiste përgjithnjë tavolocin e ngjyrave, ka-valetin, penelin... tubat e ngjyrave të vajit dhe pas-

këtaj talenti i tij do të mbështetej mbi një lapës të zi...

«Sa keq që ngjyrën e kuqe s'do të mund ta shohësh kurrë si të tillë! — mendoj me dëshpërim. — S'ke për të ndjerë kurrë shkëlqimin e madhërishëm të flamujve të kuq të festave, të kuqtë e shëndetshëm të femijëve, perëndimin e zjarrit të diellit dhe mbase s'do të arrish të kuptosh se, prapa gjelbërimeve, fshihet për sytë e tu ngjyra më e bukur, më e zjarrtë e botës, ideali i botës.»

— Daltonisti im! — tha me dhembje profesori dhe e afroi pranë vetes...

«BELBEZIMI»

«Është copëz e ditarit tim! Mbase ka për t'u shërbyer belbëzakëve si Goni... dhe jo vetëm atyre...»

* * *

Bashkëshortët mezi pritën sa e zuri gjumi fëmijën e tyre tetë vjeçar e nxituan të arrinin çfaqjen e fundit të filmit. Kur dolën në bulevard, filluan të binin pikat e para të shiut vjeshtak, që sa vinte e bëhej më i rrëmbyeshëm.

— Po sikur të zgjohet? — pyeti gruaja e shqetësuar.

— Nuk do të zgjohet! Sapo e zuri gjumi! — ju përgjegj i shoqi, ndërsa drejtohej në bufenë e kinemasë.

Një vetëtimë verbuese përfshiu hapsirën dhe pastaj një zhurmë e madhe sa i bëri xhamat të dridhen.

Vështrimi i shqetësuar i gruas që mbërthyer në atë copëz hapësire, që zbulonte dera ende gjysmë e hapur e kinemasë, prej nga shihte shiun e rrëmbyer e vetëtimat e njëpasnjëshme, të ndritshme.

— Është natë e frikshme për fëmijët! — tha ajo. Ai vuri lehtë buzën në gaz, si për ta qetësuar, e të dy hynë në sallën e madhe të çfaqjes.

* * *

Befas gjësimet e forta dhe shurdhuese e zgjuan fëmijën. Në errësirë shtriu dorën për t'ja hedhur s'ëmës në qafë, siç bënte çdo natë, po s'preku gjësendi. Atë-



here, duke u dridhur, duart kërkuan me ngulm në pjesë të ndryshme të shtratit.

— M-m-ma-ma! M-m-ma-ma! — thirri me dëshpërim djali, duke belbëzuar.

Kërceu me rrëmbim nga shtrati dhe ndezi dritën. I dëshpëruar, nisi të qajë. Dritat e fqinjëve përkundrejten qenë ende të ndezura dhe ai do të kishte vajtur atje... në qoftëse s'do ta kishte derën të mbyllur me çelës.

Atëhere ju afrua dritares e mbështeti fytyrën e kuqërremtë nga ankthi në xhamin e ftohtë e të turbulluar nga vazhdat e pikave të shiut, që rridhnin dalëngadalë tatëpjetë, pasi kishin bërë udhën e gjatë të qiellit...

— M-m-ma-ma! — belbëzoi i vogli e sërish ja krisi të qarit.

Ndriçimi i fortë i një vetëtime dhe gjëmimi zhurmëmadh i një rrufeje, që ra diku aty afër, e detyroi të zbrapsetj instinktivisht nga dritarja e të hidhej i dëshpëruar në krevatin e tij. Pastaj u mbulua kokë e këmbë, për t'ju fshehur natës së shqetsuar.

* * *

Të nesërmen, kur e ngritën në mësim, u detyrua të përsëriste disa herë radhazi të njëjtën rrokje.

— S'të është marrë kurrë goja, Goni! Po, me sa duket, nuk je përgatitur sot... ndryshe nuk shpjegohet ky belbëzim i çuditshëm. Megjithatë, vazhdo!

— B-b-bi-m-m-ma e...

— Bima, vazhdo...

— B-b-b-bi...

— Hej, po pse e përsërit!? E the një herë fjalën bimë. Tani vazhdo!

— B-b-bi-bi-m-m-m-ma e e e p-p-p-p-por-por-por-tokalles.

— Shyqyr që e nxore. Vazhdo!

— Rr-rr-rr-rr-rr...

Me gjithë përpjekjet e stërmunduara për të kon-

trolluar disi të folurit, çdo fjalë e shqiptonte të copëzuar dhe të gjymtuar si mos më keq.

Ai nuk mundi të duronte të qeshurat e mbytura të shokëve dhe u ul në bankë, me shkakun se atë ditë kishte ardhur «i papregatitur».

Të nesërmen belbëzoi më shumë se një ditë më parë. Mësuesja e detyroi më në fund të përgjigjej me shkrim...

«Ajo e humbi durimin. Po, po! S'ja shqiste sytë buzëve të mia, gojës sime të shtrembëruar me sa dukej në mënyrë të shëmtuar, ndërsa përpiqesha më kot, fare më kot, të flisja. Pastaj, kur desha të shqiptoja fjalën Kukësi, më se dhjetë herë shqiptova rrokjen, Ku-ku-ku-ku... «Kukumjaçka»— ma preu Taulanti, e klasa ja krisi të qeshurit. Edhe sot u përgjegja me shkrim. Kështu do të përgjigjesha edhe shumë herë të tjera.

U bëra belbëzak. Tashmë kjo u bë e qartë për të gjithë».

Shqiptimi i fjalëve që në qendër të vëmendjes për të. Me kohë filloi të ketë turp të flasë. E qeshura e disa shokëve çapkënë të klasës, sikur e ndrydhte më shumë. Ndonjë guxonte ta thërriste «Ku-ku».

* * *

— Goni! Përse s'e mbajte ti raportin në mbledhjen e organizatës së rinisë? Të përkiste ty ta mbaje! Ti je sekretari, ti e shkrove, — i tha Zana, tek dilnin nga mbledhja.

— Si mund të flisja? Në gojën time do të që një raport qesharak.

— S'është e drejtë, ti gabon! — tha ajo.

Ai, sikur të mos kish dëgjuar gjësendi, vazhdoi:

— Pra, do të flas më pak... nuk do të më mën-
gmojnë dhe as do të më përqeshin...

— Ndoshta dikur, kur ishin ende të vegjël, shokët
qeshnin me ty... Po sot askush s'e bën këtë. Shokët,
përkundrazi, vuajnë sa herë që ti belbëzon. Ndonjë i
papjekur, ende çilimi, mund të vërë buzën në gaz po
këto janë raste të veçanta.

— Thuamë të vërtetën, Zanë! Po të flisnim gjatë
së bashku, a s'do të mërziteshe? Se, siç e shih, edhe
me ty, mbase më pak se me të tjerët, belbëzoj si mos
më keq...

— Edhe sikur një rrokje ta përsëritësh njëmijë
herë, s'kam për t'u mërzitur kurrë!

— Nëqoftëse salla do të qeshte, si do ta ndjeje
veten, Zanë?

— Të folurit s'të ul vlerën e vërtetë, Goni! Ti prapë
ke për të folur mirë, kaq mirë, sa s'të shkon nëpër
mend.

Ai qeshi lehtë. Mori frymë thellë disi i lehtësuar.
Besimi i shoqes i kishte ngjallur shpresat e humbura.

Ai mund të fliste prapë bukur! Po, po, kështu tha
Zana. Pra, ata besonin ende në «shërimin» e tij. Edhe
mjekët besonin...

— Kush tjetër e do fjalën? — pyeti sekretari i ko-
mitetit të rinisë së shkollës, një djalosh zeshkan dhe në
dukje tepër serioz. Vështrimi pyetës përshkoi njërën
pas tjetrës radhët e sallës së madhe, si të kërkonte
dikë, midis dhjetra nxënësve.

— Ndonjë nga sekretarët e klasave të njëmbë-
dhjeta ende s'ka folur. S'kemi kohë për të humbur,
shokë! Flisni, de! (Atë çast vështroi Agronin, sikur t'i
thoshte «Ç'pret? Presim fjalën tënde!»).

Ata qëndronin të ulur pranë njëri tjetrit. Ai dë-
gjonte dihatjen çuditërisht të qetë e të shpenguar të
shoqes, ndonëse sapo i kishte dhënë fund diskutimit
të saj.

Goni u pushtua një çast nga dëshira e papërmbaj-
tur për të folur, po e tërë qenja e tij u pushtua sërish
nga frika e belbëzimit.

— Ngreu, Goni! — i pëshpëriti lehtë Zana. — Ngreu!
Tani mund të flasësh mirë...

— N-u-nuk G-g-g-gu-gu-gu...x-x-...

— Duhet guxim, Agron! — i pëshpëriti me këmbëngulje ajo.

— M-m-me-me le-le-le-je. D-do-t-të f-las u-u-u-unë.

Ç'mrekulli! Për herë të parë s'përsëriste dy herë të njëjtën rrokje.

Vështrimet u mbërthyen mbi të.

Shprehjet e tija të para qenë një përzierje rrokjesh të përsëritura ngultazi dhe të stërmunduara... Po mendimet e tija, ndonëse të shprehura me aq mundim, qenë të thella e bindëse dhe Zana përfytyroi efektin e jashtëzakonshëm që do të kishin pasur në atë sallë, që edhe kështu dukej e elektrizuar, nëqoftëse do të fliste i shpenguar. Tek zbriste nga podiumi, atë e duartrokkitën nxehtësisht. Ai u ul pranë saj dhe i shtrëngoi me zjarr dorën.

* * *

Javët dhe muajt që pasuan, qenë të lodhshëm për të. Ai u recitonte Zanës dhe shokëve të tij, në shëtitjet jashtë qytetit, vjersha të tëra të poetëve të njohur. Kështu e kishin këshilluar mjekët.

«Përse mendohen këto male» e kish mësuar përmendësh e madje, siç shprehej ajo, s'u harronte vargjeve as pikë dhe as presje. Ai qeshte gëzueshëm.

— D-dua-t-të b-bëhem a-aktor -t-teatri, — i tha një ditë Zanës. — Po do të qe qesharake ta mendosh! Një aktor belbëzak! Hej, i përfytyroj spektatorët tek mbajnë ijët me duar edhe në një monolog tragjik...

— Edhe aktor mund të bëhesh! Vullneti bën çudira, Goni! Sidoqoftë, ti duhet të stërvitësh të folurit. E ku ta dish? Mbase një mënyrë e tillë të shqiptuari të fjalëve, rrokje më rrokje, ka për ta ndihmuar në diksion aktorin e ardhshëm.

Ai qeshi me gjithë zemër, pastaj i recitoi vargjet e një kënge të bukur të festivalit të shtatë, të cilën e pëlqenin shumë.

* * *

Çfaqja amatore teatrale e studentëve të kursit të parë sapo kishte mbaruar. Salla oshëtinte nga duartrokitjet e stuhishme të studentëve.

— Goni! Goni! — thërrisnin me zjarr entuziastët e rinj. Ai përkulej herëpashere lehtë, me një ndjenjë lumturie të patreguar.

Rrezet e prozhektorit u jepnin syve të zinj një shkëlqim xixëllonjës. Me ata sy ai vështronte ngultazi vajzën e brishtë të rreshtit të parë.

Dukej se aktori student e vajza kishin nisur një dialog të heshtur në atë zhurmë të stuhishme, të cilin, veç syve të tyre, askush tjetër s'do të mund ta deshifronte.

«Sa të vogël që e ndjeja veten përpara madhështisë së saj. Mbase, po të mos kishte qenë ajo, këmbëngulja e saj dhe e shokëve të mi, s'do të mund të luaja në këtë skenë e do të kisha mbetur ende një k-k--ku-ku-ku!»

«R R E Z I M I»

Një ditë, Astriti, duke rrëshqitur në parmakët e apartamentit, papritur u rrëzua nga një lartësi jo më pak se katër metra.

Fëmijët, të trembur, dhanë alarmin.

Nëna, tek i pa një vazhdë të kuqe gjaku t'i rridhte nga veshi i djathtë, dhe sytë e mbyllur, si të kish rënë në një gjumë të thellë, e përfshiu në duar dhe doli me një frymë në rrugën plot lëvizje.

* * *

— Një tronditje truri e shkallës së rëndë! — ju përgjegj mjeku pa e vështruar në sy, në ata sy që shprehnin një shqetësim të patregueshëm. — Do t'i duhet të qëndrojë këtu 21 a më shumë ditë...

* * *

Kur fëmija u përmend mirë dhe mjegulla e dendur, që i kishte mbuluar sytë, u davarit si mjegulla e maleve në agimet e bukura plot diell, dalloi pranë shtratit t'ëmën, që s'kish lëvizur e mbyllur sy që prej dy ditësh. Sytë e mëdhenj, me qerpikë të gjatë e të zinj, si të ndonjë vajze, vështruan të habitur ambien-

tin e ri, gati të panjohur për të. Në fillim pati përshtypjen, se shihte një ëndërr të ngjethshme.

— Nënë, ku jam kështu?

— Në spital, xhani nënës.

— Përse më keni sjellë këtu?.. — vazhdoi të pyesë gjithnjë i habitur.

— U rrëzove — u përgjegj nëna dhe psherëtiu.

— Jam rrëzuar? Unë... unë... S'mbaj mend asgjë... Si u rrëzova?

Ajo filloi t'i tregonte me zë të ulët, si t'i pëshpëritte, po shpejt, në fytyrën e zbehur të të voglit u pasqyrua një lodhje e madhe (si t'i kishte treguar një histori të gjatë e të mundimshme) dhe sytë e përgjumur ju mbyllën, pa mundur të dëgjojë dot fundin e tregimit, atë fund të trishtuar, që e solli në atë pavion të heshur të kirurgjisë.

Në mbrëmjen e asaj dite, fëmija s'ndjehej aspak mirë. Të voglin e pushtuan kriza të forta: dhembje koke dhe të vjella të shpeshta. Ajo ndiqte me ankth gjendjen vërtet serioze të të birit.

* * *

Pas 40 ditësh, në një mëngjez të bukur, në kartelën e daljes, dr. Iliri shënoi me një shkrim të shkujdesur, gati të palexueshëm: «Del i përmirësuar, pas një komocioni cerebral të shkallës së tretë. Ju këshillua të ndërpresë një vit mësimet».

Vështrimit të saj plot tension nuk i shpëtoi qoftë edhe një gërmë.

«Nëqoftëse ato që shkroi, janë të vërteta, atëhere ky do të jetë, si të thuash, rrëzimi i dytë për Astritin tim... — mendoi gruaja dhe e përshkuan mornica të ftohta, si t'i kishin hedhur në trup, atë ditë të ftohtë dimri, një kovë me ujë. — Dhe mos vallë i dyti ka për të qenë më i lehtë... Një vit çlodhje... një vit pushim, mbase më i gjati pushim që të lëshojnë mjekët...»

Ajo priste me padurim fjalën e mjekut.

— Fëmija juaj kaloi një traumë shumë të rëndë! — foli pas pak mjeku. — Mund të kishte pësuar shumë më keq... Sidoqoftë, shpëtoi në saje të ndërhyrjes së shpejtë dhe sot del i përmirësuar.

Ajo priste edhe diçka tjetër nga goja e mjekut. Nëna nuk donte të besonte që pushimi i gjatë i takonte djalit të saj, Astritit. Ajo rronte me shpresë se dyzet ditë genë të mjaftueshme për kurimin e sëmundjes.

«Jo!Jo! Nuk është e vërtetë! — i jepte zemër vetes. — Ai shënim s'është tjetër, veçse një formalitet i zakonshëm mjekësor, që mbase plotësojnë në goditje të tilla të rënda...»

Po ky mendim shpresëdhënës edhe vetë asaj ju duk i pavend...

— Po, — dëgjoi zërin e mjekut. — Këtë vit shkollor, Astriti nuk duhet të vazhdojë shkollën, për disa arsye të shpjgueshme...

— Ah, sikur ta dinit, doktor, sa mirë ka mësuar gjer tani, — e ndërpreu ajo, si t'i lutej.

— Një gjë e tillë është e domosdoshme! — foli mjeku. — Te fëmija do të zhvillohen ndryshime të pashmangshme të psikikës e të karakterit. Ai nuk do të mund të përballojë dot, në një gjendje të tillë, ngarkesën mësimore...

— S'do të mjaftonte një muaj pushim? — pyeti ajo plot shpresë.

— Nëqoftëse goditja do të kishte qenë e shkallës më të lehtë, mbase do të qe i mjaftueshëm, po jo në këtë rast...

— Faleminderit, doktor! — tha gruaja si e hutuar, duke vështruar me dhembje fëmijën që afrohej me çape të ngadalshme.

Doktori e përkëdheli me dashuri.

Fëmija buzëqeshi, (nënës ju duk një buzëqeshje krejt ndryshe nga herët e tjera, një buzëqeshje disi e lodhur dhe aspak e gëzuar) dhe kapi pëllëmbën e nënës, që ajo ia shtërngoi fort, me dhëmshuri.



* * *

— Ai duhet të lërë shkollën! — i tha me zë të dridhur të shoqit.

— E di, kam biseduar me mjekun. Gjersa ky është mendimi i një komisioni mjekësor, le ta lërë! — tha më në fund.

— Dhe me çfarë gjakftohtësie që e thua!.. Sikur të ishte fjala për dy javë pushim... A e di ç'do të thotë të humbasë një vit? Mot shokët do të jenë në klasë të shtatë, kurse yni një vit më poshtë... .

— E kush është fajtor, që bën kështu? — vërejti ai. — Mos jam unë? Mos është Iliri? Janë mjekët, që e japin një këshillë të tillë për të mirën e tij? Po sikur të dëmtohet më shumë, po të veprojmë ndryshe nga ç'na këshillojnë?.. Se duhet ta dish, nesër, kur të rritet e të vuajë nga pasojat e këtij hapi të nxituar, ka për të të thënë: «Më more më qafë, nënë! Deshe të mos humbisja një vit, po humba kështu shumë të tjerë...» Dhe ç'ke për t'i thënë?..

* * *

Kur hyri në koridorin e gjerë e të ndritshëm të shkollës së re, ajo u mbërthye përpara tabelës së nderit të çetës. Ndër dhjetë fotografitë e nxënësve të dalluar të shkollës, ishte edhe ajo e Astritit.

«Astriti im!» — pëshpëriti ajo.

Pranë tabelës së nderit që një tjetër tabelë, në kartonin e bardhë të së cilës, me shkronja të kuqe të zjarra, që shënuar: «Jeta në shkollën tonë». Ajo s'e pat të vështirë të njohë që së largu shkrimin e të birit dhe një ndjenjë e ngrohtë permallimi i gufoi në zemër.

«Si mësoj unë» titullohej artikulli i shkruar pastër, bukur dhe rrjedhshëm.

Si një lumë, që zbret rrëmbyeshëm, plot zhurmë e bujë nga maja e malit, ashtu vërshuan thirrjet gazmore, bisedat e gjalla dhe sjelljet e çiltëra të bashkenxënës-

ve të të birit. Me ta vënë re, e rrethuan me mall e dashuri, si të kishin vënë në mes Astritin, shokun e tyre. E mbytnë në pyetje:

— A doli nga spitali?

— Do të vijë nesër në shkollë?

— Sa mirë që paska dalë! — thirrën fëmijët thuajse me një zë, me një gëzim të çiltër. — Na ka marrë malli shumë! .

— Sa shumë më ka ndihmuar Astriti, teto Zana! — foli Agroni. — Ndryshe, do të kisha mbetur...

Ajo nënqeshi pa ja ndarë sytë të voglit.

Ç'përgjigje t'u jepte fëmijëve që prisnin?.. T'u thoshte arësyeën e vërtetë të ardhjes në shkollë?

Po fundi, le t'ua thoshte. S'kishte për ta gjetur gjë...

Mbase Astriti s'do të ishte më ai i pari, po, ama, klasën do ta kalonte. Madje kishte një verë të tërë përpara, një kohë të mjaftueshme për të mbledhur veten. Po, po, ajo kishte vendosur të merrte tërë përgjegjësinë mbi supet e saj.

— Po, po, do të vijë, do të vijë së shpejti — u tha ajo, dhe befasi e ndjeu veten të lehtësuar, sidoqë dyshimet s'qenë zhdukur ende nga mendja e saj.

— Oh, paskeni ardhur, shoqja Zanë! — thirri e gëzuar drejtoresha, ndërsa zbriste nga shkallët me një regjistër nën sjetull.

— Thashë të dukesh një herë këtej... Kisha kohë pa ardhur...

— Si u bë Astriti? Më mirë?

— Po, po, më mirë!.. Doli dje nga spitali...

— Ashtu?! — thirri drejtoresha, pa fshehur kënaqësinë. — Atëhere shumë mirë. Shpresoj se pas dy-tri ditësh ka për të filluar shkollën e kështu, me ca përpjekje të vogla, do t'i arrijë shpejt shokët... Mos kishe edhe ndonjë hall tjetër? — pyeti ajo, duke vënë re një hutim në sytë e saj.

— Jo, jo! Erdha sa për t'ju vënë në dijeni...

— Po ç'u munduat për kaq gjë. Megjithatë, ju falënderojmë për interesimin tuaj... Eh, të ishin të gjithë prindërit kaq të kujdesshëm!

* * *

— Çfarë? Kërkon të diskutojmë prapë nga e para?.. Ne folëm shumë për këtë çështje, madje morën bashkërisht edhe vendimin tonë, prindëror, si të thuash... S'ta mbajti goja e zemra t'ja bësh të ditur shkollës dhe more mbi supet përgjegjësinë. Ç'të të them? Bëre mirë? Mbase s'bëre... Bëre keq? Mbase jo...

— Eh, ishte e pamundur të veproja ndryshe! — foli ajo me vështrimin të ngulur diku. në një kënd të dhomës.

* * *

Javët e para Astriti i përballoi mësimet me sukses dhe zemra e nënës u mbush me ngazëllim të papërshkrueshëm.

— A e sheh?! — ju drejtua të shoqit. — Për pake e humbi një vit... S'është pak, de... Nganjëherë inisiativa, në gjëra të tilla, s'është gjë e vogël e pa rëndësi... Po, se mos diagnozat e mjekëve janë gjithnjë të sakta...

— Unë s'di gjë, — ju përgjegj i shoqi, duke ngrihur supet. — Mbase është ende shpejt ta gjykojmë... Uroj të jemi të gjithë të gabuar... veç teje...

Ajo qeshi pa e vrarë shumë mendjen, se mjaft qe lodhur së menduari për djalin!..

Astriti nuk lexonte keq. Pakëz ngadalë, po kryesorja lexonte... Herët a vonë kishte për ta mbledhur veten... Një vit i humbur s'është pak, de! Një vit! Një vit!

* * *

Në orën e pestë, në mësimin e këngës, ai ishte shumë i lodhur. S'e kishte ndjerë veten ndonjëherë aq të lodhur sa atë ditë. Vërsnikët nisën të këndojnë me zë të lartë, siç këndojnë zakonisht fëmijët, një këngë

të re e të bukur. Veçanërisht Sokoli, shoku i bankës, këndonte me zë aq të lartë, sa mënt po i shponte timpanin e veshit... Apo s'kishte edhe një zë të çjerë pas të ftohtit që kishte kaluar. Astriti kishte disa ditë që s'mund të duronte zhurmën më të vogël, madje edhe gërvish-tja karakteristike e shkumësit në dërrasë që bërë për trurin e tij, tashmë të ezauruar, një torturë e vërtetë. Pas pak filloi të ndjejë dhembje të forta koke, të padurueshme, sikur t'ja shponin trurin mijëra gjilpëra njëherësh.

— Astrit! Ç'ke? Përse s'këndon, mos je i sëmurë?
— pyeti mësuesja e shqetësuar me zbehtësinë që e pllakosi papritur nxënësin.

— S'kam gjë! — ju përgjegj si i vrarë e i dërmuar e pas pak hapi gojën, kinse këndonte edhe ai. Sokoli vazhdonte të këndonte me zë të lartë. Kjo po e mundonte shumë, sa ju duk se, po të vazhdonte shumë, me siguri kishte për t'u çmendur.

— Më shurdhove more! — i tha Sokolit. — Këndo më lehtë!..

Mirëpo Sokoli s'ish në vete nga kënga e re dhe e bukur!

Dhe ai pat përshtypjen se shoku i bankës filloi të këndoje me zë të lartë.

— Merr vesh, apo jo? — e kërcënoi Astriti, duke u dridhur.

Sokoli e vështroi një çast, buzëqeshi pa të keq, si të mos kishte dëgjuar gjësendi, e vazhdoi të këndoje në qejfin e vet... Astriti s'mundi më të zotëronte veten.

— Më çmende fare! — i tha duke i rënë fort me pëllëmbë buzëve. — Ç'njeri paske qenë?

* * *

Ajo hyri në mbledhjen e prindërve fare pa qejf, sikur ta kishin detyruar të vente atje me forcë. Në tri mbledhjet e shkuara, mësuesja kujdestare kishte çfaqur hapur pakënaqësinë e saj ndaj Astritit. Mbase në mble-

dhjen e parë kishte qenë disi më e përmbajtur, shenjë kjo e respektit të dikurshëm që kishte ushqyer ndaj këtij prindi të kujdesshëm! Po, në mbledhjen e fundit, ajo s'qe kursyer aspak dhe më në fund kishte ardhur në kët përfundim: «Me sa duket, Zanë, qëndrimi i gjatë, pasiv, në spital e ka dembelosur... Shpesh vjen i përpregatitur siç duhet dhe, gjatë shpjegimit, në vend që të dëgjojë, merret me çikërrima të panevojshme. Mbase të tëra këto i ka edhe nga sëmundja që kaloi, po them se e keni edhe përkëdhelur ca si shumë!..»

Zana pat heshtur, duke duruar ankesat në adresë të të birit të saj të pafajshëm.

Edhe në këtë mbledhje, mësuesja e përqëndroi vëmendjen te Astriti, se gjoja ai po bëhej shkaktar i shumë çrregullimeve të klasës së tij.

— Shembulli i keq i Astritit, që dikur ishte nxënësi i shkëlqyer, do të ketë pasoja të papëlqyera. Ai është bërë tekanjok i madh! U dhashë dje për të zgjidhur një ushtrim, madje jo edhe të vështirë, dhe ai e la përgjysmë... «S'e zgjidh dot», më tha. Çudi, Zanë, ai s'ka qenë kurrë kaq i pavullnetshëm dhe kaq i pa-bindur!.. Mos vallë... .

— Astriti s'do të vijë më në shkollë, mësuese! — foli Zana e tronditur. — Mjekët i parashikuan me kohë të gjitha sa më thatë, po atë që është lehtë ta pranojë cilido tjetër në botë, zemra e nënës e paska aq të vështirë... .

DELIRIUM TREMENS

Në derë, dikush trokiti lehtë dhe Dardani nxitoi t'ja hapë.

— Qenke ti, Liro?

Mysafiri buzëqeshi me pahir dhe i zgjati pa qejf dorën. Dukej i mërzitur. Diç e shqetsonte. Sa herë vinte në këtë shtëpi, pushtohej padashur nga një ndjenjë e çuditshme, një farë ankthi që e mundonte dhe që ai s'dinte t'i jepte shpjegim...

— Dëgjova se ishit i sëmurë, prandaj erdha.

— Po, eja, eja, brenda!— i tha Dardani, duke s tërhequr nga krahu. Liri s'e kuptoi përse e tërhoqi me aq nxitim. — Është fqinji ynë. S'e duroj dot... më ndjek çap pas çapi!— i pëshpëriti ai, si t'i tregonte një të fshehtë të madhe. Mysafiri ndjeu në frymën e të sëmurit erën karakteristike të rakisë.

«Prapë paska pirë, — mendoj me dëshpërim, — megjithëse është i sëmurë... Hej, Dardan, Dardan».

Të dy u ulën rreth një tryeze të vogël trekëndëshe, me kënde të deformuara; këto ishin gjurmët e grindjeve të tij të zakonshme, sa herë kthehej i dehur në shtëpi. (S'linte gjë pa thyer e pa përplasur në raste të tilla). Liri vështroi ngultas të sëmurin; sytë e alkoolistit të vjetër ju dukën si të ngrirë; faqet e kuqërremta i qenë futur thellë, kështu që i shquheshin më shumë mollëzat, që shembëllenin me dy xhunga të mëdha tumoroze.

Ai ndjeu ankthin t'ja pushtojë fort zemrën, si të qe një meduzë gjigante shumëkëmbëshe, kur i hodhi një vështrim dhomës së mobiluar aq varfër.

«S'i mbeti gjë në shtëpi! — mendoj. — S'la gjë pa shitur e rrënuar për atë të mallkuar farmak. Rrogën e vet raki e meze e bëri».

Liri bëri përpjekje për të mos i kujtuar ato ditë të paharruara, dhjetë vjet të shkuara, po qe e pamundur, sepse ato qenë bërë, si të thuash, një kujtim torturo-njës në kuptimin e vërtetë të fjalës. Ja tek e shinte

Dardanin tridhjetëvjeçar, të bëshëm e simpatik, tek i zgjaste me dashmirësi pëllëmbën goxha të madhe, aq sa, me shaka, e thërrisnin edhe «Pëllëmba».

— S'kam fare oreks! — i ishte ankuar Dardani. — Kam tri javë që s'më hyn gjë në sy...

— Do të gjej unë një ilaç të mirë, — i kishte thënë Liri me ton gazmor, si të donte t'i ngjallte kureshtjen mikut të tij. — Shpesh e këshillojnë edhe mjekët!

Vështrimi kureshtar i Dardanit qe mbërthyer te sytë e tij.

— Hë de, thuaje të shkretën!..

— Një gotë e vockël, para buke, të bën punë të madhe, o vëlla, dëgjove?.. Pakëz, se ndryshe mësohesh, — i kishte thënë ai me një farë krenarie, si t'i kishte gjetur barin më të mirë në botë.

Pas dy javësh, Dardani ju duk se kishte ndryshuar, kishte marrë një ngjyrë të kuqerremtë e i kishte rënë një nur i bukur. Liri kishte ndjerë një farë ngazëllimi.

— Po, po, ilaç më të mirë s'kam për të gjetur, o Liro vëllai. Dhe qenka i lezetshëm në të pirë, qerratai!..

— Se mos mësohesh, o derëzi! — i kishte thënë Liri duke i buzëqeshur. I qe dukur se, po t'i drejtohej me një ton të ashpër, do t'i vinte shkelmin mirënjohjes së pakufishme që tregonte Dardani ndaj tij. Fundi oreksi i qe kthyer dhe oreksi mbi të gjitha! Pa të tjerat rregullohen. Kështu kishte arësytuar Liri.

Kaluan dy muaj dhe gota e vockël s'i hynte më në

sy Dardanit. Filloi të pinte nga dy gota dhe, me rast, bie fjala, kur takonte ndonjë shok a mik, rrëkëllente edhe tri - katër gota. Si pa u kuptuar që bërë alkoolist. Dukej se tani s'kishte qëllim tjetër në jetë, veçse të pirrit. Ua vari të gjithave: punës, familjes, shoqërisë...

Sa e kishte vrarë ndërgjegjja Lirin! I kishte dhënë një këshillë të çmendur, pa u menduar thellë, dhe ja pasojat!..

Ai dhe shokët e punës qenë munduar ta largonin nga ky ves, po që e pamundur. Eh, si që shndërruar ai Dardan, s'shihej dot me sy. Pa që edhe martuar e kish lindur tri fëmijë. Dy të parët i kishin vdekur, kurse i treti kishte lindur idiot. Edhe fëmija i tretë, një ditë kishte vdekur. «Tek e fundit, s'bëri keq, — kishte thënë Dardani, — se ç'kuptim kishte jeta për idiotin e vogël!» Megjithëse thellë, në shpirt, ai ndjente dhemshuri për fatin e keq të fëmijës, arësytetime të tilla ishin, si të thuash, një farë ngushëllimi për të.

Liri befasi u përmend. «Çudi, — mendoj ai, — si e humba mendjen kështu? Si është e mundur që gjer tani Dardani të ketë qendruar si një mumje pa e hapur gojën? Mbese ka folur dhe s'e dëgjova. Ku ta dish?!..»

— Hm! Po ku u ftohe? — e pyeti.

— Ku? He, ashtu... U ftoha!.. — ju përgjigj Dardani me zë gjithnjë të ulët, duke i zvarritur fjalët, si të qenë plumb të rënda.

«Tani flet pa lidhje. Jo, s'është rakia fajtoje për sonte. S'është i dehur! Ka pirë a s'ka pirë një gotë! — Ai gjykoj nga niveli i rakisë së shishes, që Dardani e kishte vendosur mbi dollap. — E pira ka filluar të lërë vragë të pashlyeshme në trurin e tij. Është bërë si fëmijë!..»

— Më pyete gjësendi? — u hodh papritur Dardani si me dyshim dhe si i trembur.

— Ku u ftohe, të pyeta!

— Aha, jashtë u ftoha! Jashtë!

«Ka filluar të harrojë shpejt, shumë shpejt!» — mendoj Liri.

— Kishe pirë?

— Po, po, ashtu... pakëz, një... litër!..

— Besa pak, pse s'thua?! «Tani edhe një litër s'i duket gjësendi», — mendoi Liri. — Të zuri gjumi jashtë, u dehe, — ju kthye pastaj Dardanit me zë të lartë e të pakontrolluar, aq sa edhe vetë mbeti i habitur. E pra, dikur matej më shumë para se të bisedonte me të dhe nuk sillej kaq i shpenguar ndaj tij.

— Më pyete gjësendi, o Liro? — pyeti i sëmuri tërë dyshim. E ndjente edhe vetë se kujtesa po e tradhëtonte nga dita në ditë, megjithëse s'i kishte kaluar të dyzetekatër vjetët!..

Atij ju duk e tepërt, madje e mërzitshme, t'ja përsëriste atë pyetje të rëndomtë. Ai e kishte të qartë arësyen e ftohjes, e dinte mirë. Qe dehur dhe e kishte zënë gjumi jashtë, në një kënd të errët të një apartamenti, një natë shumë të ftohtë janari. Dhe mund të kishte ngrirë, nëqoftëse s'do ta kishte gjetur një roje nate.

Dardani u ngrit me mundim, duke lëshuar një rënkim të zgjatur dhe duke ecur me luhatje, si të qe mbi susta, ju afrua dollapit të sakatosur e të gjymtuar si mos më keq.


«Në këtë shtëpi vesi ka vënë vulën e tij të shëmtuar në çdo gjë, gjer edhe te dollapi!» — mendoi Liri.

— Ku shkon? — Pyetja i shembëlleu edhe atij vetë fort e çuditshme, veçanërisht toni i fortë gati si një urdhër. Hej, ç't'i thuash kësaj. Ai kishte ardhur si mysafir në këtë shtëpi dhe i lejonte vetes pyetje të tilla qesharake. Edhe kë pyeste kështu? Të zotin e shtëpisë!..

Shkurt, ai ndjente thellë, në shpirt, një ndjenjë të përzier zemërimi dhe dhembjeje të pashpjegueshme.

* * *

— Të pimë! — foli Dardani duke vënë shishen e rakisë mbi tryezë. — S'kemi pirë qëkuri bashkë!..



— Je bërë profesionist në pije! — nënqeshi Liri me hidhërim.

— Hi-hi-hi, — qeshi Dardani si një idiot, — një shishe s'është gjë për mua, ... njëzë, po jo më shumë, jo më shumë...

Befas dora që mbante gotëzën e mbushur për të tretën herë gjer në grykë, ju drodh, si t'ja kishte përshkuar një rrymë e fortë elektrike. Ai vështroi i tmeruar nga dera.

— Dëgjon gjë? — pyeti me zë të dredhur dhe i zbehur për vdekje.

Liri mbajti vesh.

— Asgjë! — tha.

Frika, që e kishte pushtuar, sa vente e bëhej më e madhe. Tani dridhej i tëri, si ta kishin zënë një palë ethe të forta.

— E mbylla mirë derën? — pyeti me dyshim.

— E mbylle! — ju përgjegj Liri i hutuar, pa kup-tuar gjësendi.

Ai shkoi me nxitim te dera dhe me gishtrinjte që s'i bindeshin, rrotulloi çelësin për të dytën herë.

«Po ç'e shtyn të veprojnë kështu!?» — mendoi Liri, gjithnjë i habitur.

Dardani ngjeshi pas derës veshin dhe, me sytë të hapur, filloi të ndjekë plot ankth çapet e njohura që ngjisnin njëren shkallë pas tjetrës, ashtu pa u ndjerë.


— Armiqtë e mi! Duan të më vrasin! — ju kthye Lirit me një zë gati të shuar dhe rrëmbeu me një frymë nga tryeza thikën e madhe të bukës.

* * *

— Alo! Alo! Jeni ju, shoku shef?

— Po, po, unë! Ç'ka ndodhur?

— Një njeri është hedhur, rreth orës 20.00, nga kati i dytë!



— Çfarë rruge?... Ah, po, po, ju kuptoj! Dëgj mos bëni asnjë veprim, gjersa të vimë në!..

Fill pas ngjarjes, apartamenti mbahej në një vëzhgim të rreptë. Dera e viktimës ishte gjetur e mbyllur dhe ruhej mirë nga jashtë.

— Petrit! Lëri ato dokumenta mënjane dhe eja të shkojmë, ora është 20,05. S'duhet humbur kohë!

Petriti, një djalosh rreth të njëzetepesave, me një trup të gjatë, të zhvilluar në mënyrë harmonike, e ndoq pas me dëshirë të madhe. Kishte kohë që lexonte dokumenta të ndryshme, për t'u specializuar në këtë degë veçse tani po i jepej rasti të njëjti me një material gjallë jetësor.

— Përse të jetë hedhur, vallë? Ç'e ka detyruar?

I pushtuar nga një mori pikëpyetjesh, u gjet papëndeher përpara derës së hapur të maqinës.

— Hyrë, Titi! Ke rënë në mendime të thella, — buzëqeshi me dashamirësi shefi.

— Është rasti i parë dhe emocionet janë të kuptueshme, shoku shef, madje edhe gabimet.

«Ka sy prej hetuesi!» — mendoi shefi. — Këtë shtje do ta ndjekësh ti, Petrit! Po, po, mos u habit! Vetëm ti... Sado e rëndë qoftë, sado e koklavitur...

Titi u drodh lehtë.

— Këtë s'e prisja! — tha e u mbështet lehtë në koktukun e «gazit».

* * *

Shefi, Petriti dhe fotografi mezi çanë koridorin e gjerë të udhëtarëve kureshtarë, që kishin rrethuar vendin e ngjarjes.

Në trotuar dergjej viktima. Mbi të që përkulur Shpërtimi, doktori i mjekësisë ligjore, që diç i mjekonte.

— Si është gjendja e tij?! — pyeti shefi.

— Ka pësuar një komocion të shkallës së dytë. He-

përhë ndodhet jashtë rrezikut. Ka thyer dy brinjë... E keqja më e vogël, nga një rënje e tillë.

Kur i sëmuri u çua urgjentisht në spital, ata të katër, shefi, hetuesi i ri, doktori dhe fotografi u drejtuan nga apartamenti, drejt së fshehtës së madhe. Titi kishte parë një film të bukur mbi një ekspeditë eksploratorësh në xhunglat e Guinesë së Re, që ndesheshin në çdo çap me të panjohurën e egër... Nga çasti që shefi i ngarkoi ndjekjen e kësaj çështjeje, ju duk vetja një eksplorator, mbase i një krimi të kredhur në errësirë të plotë. Dhe atij do t'i duhej të kërkonte, gjer në zbulimin e së fshehtës, në zbulimin e dorës fajtores.

* * *

Ata ngjitën me çape të shpejta shkallët e vogla të dy kateve. Një roje, që gjer ahëre diç bisedonte me një grua, u kthye e tha:

— Është fqinja e viktimës! Diç do të dëshmojë.

— Ç'mund të dëshmoni? — pyeti Petriti menjëherë gruan, duke lënë mënjanë çdo ceremoni të rastit.

— Po ja, po ngjitesha. Bri meje kaloi një burrë, që po i ngjiste shumë shpejt shkallët. U ndal te Dardani. Tek kërkoi çelësin, se s'e gjeja dot, Dardani më hodhi një vështrim gjithë dyshim. S'di përse, po ka dy javë që më sheh kështu, dhe e mbylli menjëherë derën.

— Po pastaj?

— Pastaj e mbylli derën me çelës.

— Kështu e mbyll zakonisht?

— Jo! Javët e fundit i është bërë zakon.

— Po e shoqja ku ndodhet?

— Te e ëma. Sa herë grinden, atje shkon dhe kthehet prapë... «E ka bërë pija të keq!» — thotë.

— Pastaj...

— Pas nja dhjetë minutash filloi të thërrasë si i çmendur: «Mos më vrisni! Mos më vrisni! Jam i ndershëm! Mos!» E ku mbahen mend ato që thoshtë? Një

herë përmendi edhe fjalën gjarpër: «Ah, gjarpëri! — thirri me të madhe.

— Ashtu? — zëri i hetuesit të ri tingëlloi i habitur.

— Lëre se çfarë zhurme u bë pastaj. Me siguri ndonjë përlëshje. Çfarë s'përplasej pas dere!.. Pastaj pllakosi heshtja. Pas nja dy minutash më erdhën në vesh zëra të ndryshëm njerëzish. Diç kishte ngjarë. Dal në dritare, ç'të shoh? Dardani kishte rënë përmbys në trotuar...

* * *

Hetuesi rrotulloi dy herë çelësin e posaçëm dhe, me një cohë të vendosur mbi dorëzën, hapi ngadalë derën, si të hapte siparin e një tragjedie të madhe. Ai shtangu në vend. Shtangën edhe të tjerët. Në mes të rrëmujës së madhe, që sundonte në dhomë, ulur në një karrige, qëndronte një njeri. Ai nuk çfaqti as shenjë më të vogël të interesimit për të porsaardhurit. Dukej si i ngrirë në një pozë të çuditshme. Vështrimi i të panjohurit që mbërthyer i palëvizshëm dhe aspak shprehës, në drejtim të kanateve të hapura të dritares. Fytyra e tij i shembëlleu hetuesit si një maskë e ngrirë, pa pikë jete.

«Mos është i vdekur?» — dyshoi.

Po krahërori i të panjohurit u ngrit dhe u ul në mënyrë ritmike.

— Ai është! — dëgjoi pëshpëritjen e gruas, që u tremb nga pamja jo e zakonit e burrit të panjohur.

— Cili jeni ju? — ju drejtua të panjohurit.

I panjohuri u duk se s'dëgjoi gjësendi.

— Si ju quajnë?

Sërisht sundoi heshtja.

— Është në gjendje stupori psikogjen, një farë go-ditje e rëndë psikike, — dëgjoi zërin e shefit.

— Ah, po! — u kujtua përnjëherësh hetuesi i ri.

— Në këtë gjendje ai nuk kupton asgjë nga ato që i thuhën dhe mbase do të duhen të kalojnë disa orë, gjersa të qartësohet vetëdija e tij.

Në kërkim e sipër, poshtë dritares, sytë e Petritit shquan thikën e hedhur nga viktima, pak çaste përpara se të hidhej.

— Dikush e ka kërcënuar, shoku shef! Ai është përpjekur të vetëmbrohet, po, duke e ndjerë veten të pafuqishëm, është detyruar të hidhet.

— Cili ta ketë kërcënuar? — pyeti shefi.

— Ka shumë mundësi ky! — u përgjegj Petriti, duke treguar të panjohurin e çuditshëm.

— Mbase, po një kriminel është zor të bjerë në një gjendje stupori psikogjen. Çfarë e tronditi, vallë, kaq shumë të panjohurin. Mos vallë të dy u kërcënuan nga i njëjti shkak? Nëse i pari arriti të hidhej, i dyti s'mundi dot.

Mbase kur të marr në pyetje Dardanin, nëqoftëse shpëton nga vdekja, shumë pikëpyetje do të kenë përgjigjen e tyre.

— Dardani shpëtoi! — u dëgjua zëri i mjekut, që porsa kishte telefonuar në klinikë. — Ka pësuar një tronditje truri të shkallës së dytë dhe vjen në vete pas tri ditësh.

Hetuesit të ri i ndryshoi çehreja.

— Po sikur tek ai të zhvillohet një harresë e plotë për të gjitha ngjarjet para rrëzimit? E ashtuquajtura amnesia retrograde shpesh është pasojë e pashmangshme e tronditjeve të rënda. Atëhere mbetet për të pyetur të panjohurin dhe ky është varianti më i keq në rastin tonë. Sikur të ketë gisht në këtë ngjarje, ka për ta ngatërruar lëmshin që ç'ke me të...

— Për fat të keq, edhe i dyti s'do të mund të përgjigjet për të njëjtën arësyë, — foli mjeku.

— Mos keni parasysh amnesinë retrograde, që shoqëron stuporin psikogjen?

— Pikërisht!

— Sido që të jetë, është e pamundur të mos i gjesh fillin një lëmshi, sado i mpleksur qoftë! — i dha zemër shefi. — Duhet kërkuar me durim...

— Viktima s'ka qenë i dehur, — foli Titi, duke parë me vëmendje nivelin e rakisë në shishe, që, për çudi, i kishte shpëtuar rrëmujës dhe qëndronte indiferente, si të thuash, atje mbi tryezë.

«Gjithçka ka hedhur, kurse shishen, jo!» — mendoi Petriti.

— Në mos qoftë kjo, shishja e dytë! — provokoi shefi.

— Edhe pijaneci më i madh s'do të pinte brenda dhjetë minutash një shishe të tërë... Veç kësaj, kërkimet për një shishe të tillë të dytë, nuk dhanë ndonjë përfundim.

Shefi vuri buzën në gaz, i kënaqur me mprehtësinë e nxënësit të tij.

— Pra, si përfundim, viktima s'ka qenë e dehur, — tha Petriti, duke ju afruar të panjohurit për të ndjerë erën karakteristike të alkoolit.

— Edhe ky ka...

Po s'mundi të mbarojë dot frazën. Papritur e pakujtuar, i panjohuri u gjallërua, i dha një të shtyrë të fuqishme Petritit, dhe u përpoq të dalë me vrap nga dhoma, po duart e fuqishme dhe të stërvitura mirë të shefit e mbërthyen paq. I panjohuri, me leshrat e ngritura, me sytë e kërcyer jashtë, dukej se jetonte në një botë tjetër.

— Në mos gabohem, është fuga, apo ikja, faza e dytë e stuporit psikogjen! — ju drejtua shefi doktorit, duke e ulur të panjohurin në karrige, pa ja çliruar ende duart.

— Keni një kujtesë fenomenale, shef! — vërejti mjeku. — Ndonëse kanë kaluar dhjetë vjet nga koha, kur zhvillonim së bashku kursin e mjekësisë ligjore, megjithatë...

— Dhe, megjithatë, i panjohuri edhe në këtë fazë të dytë s'është në vete, s'është i ndërgjegjshëm për ato që bën, shtoi hetuesi i ri, ndërsa fërkonte lehtë me dorë gjurin e vvarë.

Dy të tjerët vunë buzën në gaz.

* * *

Për Lirin të gjithë flisnin fjalë të mira, qoftë kolektivi ku punonte, qofshin banorët e lagjes ku jetonte. Madje ata as që donin të besonin se ai mund të kishite gisht në skandale të tilla. Të gjitha analizat, nga ana tjetër, përjashtonin praninë e një personi të tretë brenda në dhomë. Te viktima s'kishte asnjë shenjë të dukshme që të tregonte se mbi të ishte ushtruar dhuna.

Po ç'e kishte detyruar, vallë, të thërriste «Mos më vrisni!», «S'jam fajtor!», «Ah, gjarpëri!»? Padyshim, i qe dukur si i tillë, sepse ekspertiza e hollësishme e kishte përjashtuar një mundësi të tillë. Po ç'e detyroi, vallë, të hidhej nga dritarja?

Po nga kush mund të shpresonte Petriti për zgjidhjen e enigmës?

Atij i duhej të ecte me këmbët e veta në këtë shteg të errët. Qe, si të thuash, para një provimi të madh, para provimit të jetës. «Tezë e vështirë për t'u zgjidhur! — mendoj. — S'krahasohet me dhjetra teza të zakonshme klase, të hartuara me zemërgjerësinë e pedagogut, që mund t'i plotësojë edhe me pyetje ndihmëse. Po këtu ç'përgjigje do të jepte?

* * *

Dy ditë më vonë, ai u mbërthye në sallën shken-core të bibliotekës. I dukej vetja se qe gozhduar pas asaj tryeze plot shkëlqim. Ai lexoi shumë materiale të vendit e të huaja kushtuar alkoolizmit. S'para ndjehej i kënaqur nga leximet e para. Asnjë nga rastet e përshkruara nuk i shërbeu si një fakt krahasues me rastin e tij.

Kaluan orë kështu kur, padashur, ai thirri me zë aq të lartë, sa që ngjalli habi te një filolog, që studjonte bri tij. Në kapitullin e fundit, mbi psikozat alkoolike, përshkruhej aq bukur një gjendje e veçantë, e quaj-

tur «delirium tremens». Ky qe një rast thuajse i ngjashëm me atë të viktimes së tij!

* * *

Pas disa ditësh, Petriti u takua me shefin e tij, i cili, duke i buzëqeshur me dashamirësi, i tha:

— E Petrit, mos do të ma lësh mua vazhdimin e procesit?

— Ah, jo, për fat të keq, jo! — qeshi me një kënaqësi të dukshme hetuesi i ri. Më së fundi arrita të gjej fillin e lëmshit të mpleksur...

— Ah, kështu? — thirri i gëzuar shefi.

— Padyshim! Veç të tjerave, një ndihmë e pagmuar qe për mua edhe dëshira e Lirit. E ndjente veten më mirë dhe kishte ngulur këmbë të më takonte. Mjekët qenë të detyruar ta lejonin.

— Pra, çfarë përfundimi keni arritur?

— Urdhëroni, shef, — i tha, duke i zgjatur një fletore.

* * *

— Nuk e keni përshkruar keq, Petrit! — foli shefi i kënaqur. — E pra, çfarë mendoni?..

— Jam thuajse i bindur se ndodhemi përpara një të sëmuri të pushtuar nga kriza tipike e delirium tremens... një farë psikoze alkoolike.

Siç e vutë re nga përshkrimi, një njeri i tillë ka alucinacione të shumta. Dëgjon klithma, të shtëna pushkësh, të shara, kërcënime. Shpesh përmbajtja e zërave të njerëzve është e pakëndshme. E akuzojnë për krime e vepra të shëmtuara, që s'i ka bërë. Nga njëri vesh dëgjon zëra, që e mbrojnë, e nga veshi tjetër zëra që e akuzojnë. I sëmuri vuan tmerrësisht. Ai i jeton plotësisht këto skena të llahtarshme. Zërat japin dënim me vdekje. Ja tek e sheh veten në trikëmbësh. Ja tek sheh kazanin me ujën që vlon, ku do ta ziejnë për së gjalli. Shpesh sheh

kafshë të ndryshme, me qindra mijë, që e sulmojnë, gjarpërinj që zvarriten drejt tij, morra e insekte të ndryshme, që i ngjiten fort pas trupit e që më kot përpiqet t'u shpëtojë. Shpesh, i kërcënuar nga vdekja e llahtarshme imagjinare, pranon të hidhet nga ndërtesa shumëkatëshe. Te alkoolistë kronikë, këtë gjendje e ndihmojnë edhe sëmundje të ndryshme, si pneumonia, etj.

Vështrimi i shefit që i ngrohtë e dashamirës. Ai shihte te Petriti një hetues të zotin, që dinte të kombinonte njohuritë e thella profesionale me ato të degëve të tjera, dhe veçanërisht me ato të mjekësisë ligjore.

* * *

Të tre prisnin në dhomën e mjekut, ulur në kolltukët e mbuluar me copë të bardhë. Nië infermiere zeshkane u solli pas pak Dardanin. Ai dridhej i tëri. Binin në sy sidomos lëvizjet e ndërlikuara të duarve, si të drejtonte një maqinë.

— Ka përshtypjen se ndodhet në vendin e punës! — sqaroi mjeku. — Tani është duke punuar në torno...

Dy të tjerët, të habitur, s'ja shqitën sytë.

— Mund të fillosh, Petrit! — ju drejtua shefi.

— Të tri metodat, që do të eksperimentoj, janë të bazuara në sugjestionimin indirekt! — shpjegoi Petriti, duke ju afruar të sëmurit.

— Dani! Ç'është ai që zvarriset në dysheme? Ë? ..

Dardani shikoi ngultas në dysheme dhe u praps i tmerruar.

— Gjarpëri, — thirri me të madhe e nxitoi të fshihej pas Petritit.

Hetuesi ndjeu dridhjet e forta të g'shtrinjve të Dardanit të mbështetur fort në supet e tija, si të kërkounin mbrojtje nga rreziku që i kanosej.

— Simptoma është tipike. Quhet e Lipmanit, — sqaroi Petriti.

Dy të tjerët aprovuan në heshtje, pa fshehur admirimin e tyre.

Pastaj Petriti mori receptorin e telefonit në dorë.

— Dikush ju kërkon në telefon, kërkon të flasë me ju...

Dardani rrëmbeu menjëherë telefonin dhe zhvilloi një bisedë të gjatë, me pyetje e përgjigje, me sinjalin e ndërprerë të centralit automatik të qytetit.

— Simptoma quhet e Ashafenburgut! — sqaroi Petriti.

Dy të tjerët aprovuan në heshtje.

— Të ka ardhur një letër nga familja! — ju drejtua të sëmurit Petriti, duke i dhënë një letër të barahë.

Ai nisi të lexojë me pasion dhe me zë të lartë një letër imagjinare.

— Është simptoma e Rejhartit! — tha Petriti. — Të tri shenjat, më mjaftojnë plotësisht për të përcaktuar në mënyrë krejt të pavarur krizën e delirium tremens. Edhe nëqoftëse do të qe zhvilluar amnesia e plotë retrograde të i sëmuri ynë, këto shenja thelbësore dhe të tjera, që plotësojnë kuadrin interesant të kësaj psikoze alkoolike, do të ishin plotësisht të mjaftueshme për të zgjidhur enigmën e asaj nate të paharruar.

— Të lumtë hetuesi im! thirri me entuziazëm shefi, që kësaj radhe nuk mundi ta përmbajë gëzimin dhe krenarinë e pashoqe të mësuesit për nxënësin e denjë.

BASTI I ÇMENDUR

Ai kthehej në qytetin Salson, pas një turneu të gjatë e plot sukses në një sërë qytetesh të rëndësishme të vendit. Leksionet e tij, kushtuar dëmeve të duhanit, qenë ndjekur me interesim të madh nga mijëra dëgjonjës dhe qenë vlerësuar lart nga ata. Një grup mjekësh, madje, qenë betuar se do të ishin nga të parët që do të ndiqnin shembullin e tij. Po përlëshja me monopolet do të qe e pashmangshme dhe e ashpër. Profesor Sidnej s'kishte harruar aspak bashkëbisedimin e acaruar me mister Xhejnin, një nga monopolistët më të mëdhej të duhanit.

Xhejn s'u kishte kushtuar vëmendje të veçantë punimeve shkencore dhe leksioneve të profesorit në lëmin e duhanit. E kishte quajtur thjesht një lektor të rëndomtë, aspak të dëmshëm. Porse autoriteti i këtij propaganduesi entuziast të dëmeve të duhanit filloi të marrë përpjestime kërcënuese për interesat e Xhejnit. Më në fund, ai vendosi të njihej me kundërshtarin, forcën e të cilit, kundër dëshirës, qe i detyruar ta merrte parasysht.

Profesorit ju kujtua ajo mbrëmje vjeshte, kur për herë të parë njohu mister Xhejnin. Sidnej kishte mbajtur një referat të shkëlqyer në klubin e të rinjve. Në referat bëhej fjalë për zbulimin e një elementi radioaktiv në lëndën e duhanit. Teksa dilte nga klubi, atij ju afrua një burrë i shkurtër, i shëndoshë dhe në dukje një tip i gjallë.

— Më lejoni, dr. Sidnej, t'ju përgëzoj për leksionin e

shkëlqyer që mbajtet. Nuk e teproj kur them se, edhe për mua, prodhonjës in më të madh të duhanit, efekti ka qënë i pashpresueshëm.

— Padyshim... Ju dukeni i emocionuar... mister...

— Mister Xhejn! — nxitoi të prezantohet fabrikanti, me një buzëqeshje të akullt.

— Ah, Xhejn! Posi, posi, kam dëgjuar për ju... — u hodh Sidnej me një ton ironik.

— Profesor! Do të ishte e kotë t'ju fshihja qëllimin e vërtetë të 'ardhjes sime, — tha Xhejn, duke ndryshuar papritur shprehjen e fytyrës dhe tonin e bisedës.

Vështrimi i mprehtë i profesorit u mbërthye te sytë e vegjël dinakë, gati të mbyllur të Xhejnit.

— Më në fund, — filloi të flasë monopolisti, — ju duhet të kuptoni, sa s'është vonë, se lufta që keni nisur kundër vesit të të pirit duhan, është e paracaktuar të dështojë. E para, se të pirët është gjithnjë një ves dhe, siç mund të merret me mend, të shpëtosh nga ai është aq e lehtë, sa ç'mund të jetë shkëputja nga njëra tjetra e gjysmësferave të vakumit të Magdeburgut, — dhe qeshi me gjithë zemër, i kënaqur, padyshim, për krahasimin që i erdhi ndërmend papritur dhe që i dha aq forcë mendimit të tij.

— Dhe arësyeja e dytë, mister Xhejn?

— E dyta, profesor Sidnej, dashur padashur ju do të bëni armiq fabrikuesit e shumë të duhanit, të cilët nuk do t'ju kursejnë qoftë edhe pse ju jeni mjaft i njohur... Ju e kuptoni, profesor, bëhet fjalë për interesat tona personale...

— Ç'doni të thoni, më në fund, mister Xhejn?

— Kam një propozim të leverdisshëm për ju! Tashmë gëzoni një popullaritet të madh si studjues i dëmeve të duhanit. Ju jeni në dijeni se firma jonë ka nxjerrë në qarkullim kohët e fundit cigaret «Superfiltër», të cilat reklamohen gjerësisht nga ne si krejt të padëmshme. Se, ç'është e vërteta, në prodhimet e llojeve të mëparshme qemë detyruar në ndonjë rast edhe të vinim në dijeni

blerësit për të ashtuquajturat «dëme». Mjekët e shoqërisë sonë, Bell e Stjuart, gëzojnë një farë emri të mirë. Ata kanë nënshkruar në paqetat e mëfarshme për këtë ose atë rrezik të duhanit, duke qenë të bindur se blerësit do të hiqnin dorë nga pirja, sa ç'mund të heqim dorë ne nga prodhimi i tyre... Kurse, në paqetat e fundit «Superfiltër», ata kanë nënshkruar për garanci të plotë ndaj çdo dëmtimi të mundshëm.

— Dhe shpresoni që njerëzit t'u besojnë këtyre profkave? — e ndërpreu Sidnej, duke humbur durimin.

— Ç'gjë e mrekullueshme do të ishte, profesor, — vazhdoi Xhejn, si të mos kish dëgjuar gjësendi, — sikur të drejtonit laboratorin tonë mjekësor! Bell e Stjuart janë mjekë të zotë, po, për fat të keq, ende nuk kanë fituar titullin e lartë të profesorit. Firma juaj do të hiqte çdo dyshim.

— Sa propozoni për këtë marrëveshje, mister Xhejn? — e pyëti profesori me një farë interesimi.

— 3000 dollarë në muaj, doktor! Një shumë jo edhe e vogël... apo jo, Sidnej! — tha Xhejn, duke e vështruar me dinakëri.

Sidnej psherëtiu thellë dhe vështroi një copë herë në heshtje Xhejnin, si të qe thjesht një objekt interesant studimi.

— Ende besoni se mund të blini me dollarët tuaj nderin e shkencëtarëve, shëndetin dhe jetën e miliona njerëzve? Hej, mister Xhejn, ju që të gjithë jeni një-lloj, keni një fytyrë, një gjuhë të përbashkët...

— Oh, si të dëshironi, profesor! S'desha, veçse t'ju ofroja ndihmën time sado të vogël e të thjeshtë... Hm, me sa kam dëgjuar, do të mbani një leksion të gjatë në qytetin tonë Salson?

Mjeku pohoi lehtë me kokë.

— Sidoqoftë, do ta keni të vështirë, profesor. Unë nuk dua t'ju frikësoj. Veçse t'ju kujtoj se dr. Bell e Stjuart nuk kanë për t'ju lejuar t'i servirni çdo përfundim, të ashtuquajtur shkencor, masës së thjeshtë të dëgjonjësve, e cila është e gatshme të bindet pa

ndonjë vështirësi. Ne do të kundërveprojmë, profesor, po, po, në emër të një ligji, të cilin ju nuk duhet ta harroni dhe aq më shumë ta nënvleftësoni.

— Për fatin tuaj të keq, mister Xhejn, e keni harruar përmbajtjen e plotë të këtij ligji të fizikës. Forcat tona kanë kahje të kundërta, njëra prej të cilave synon të ruajë shëndetin dhe jetën... kurse tjetra ta pengojë me çdo mjet të mundshëm. Për hir të fitimeve tuaja përrallore, ju s'do të ndaleshit edhe përpara krimit më të shëmtuar.

Xhejn s'u përgjegj. Sytë e vegjël, gjithnjë gjysmë të mbyllur, ju errësuan nga mendime të zymta, e nënqeshi egërsisht.

Ata u ndanë. Befas Sidnej dëgjoi ta thërrisnin.

— Profesor, profesor!

Ai ktheu kokën dhe njohu mjekun Njuxheks, një djalë të ri rreth 25 vjeç.

— Mirëseardhët, profesor, në qytetin tonë! Ju prisnim me pa durim!

Sidnej buzëqeshi i kënaqur dhe i rrahu përzëmërsisht shpatullat.

— Ju kanë rezervuar një pritje të shkëlqyer, profesor! Leksionin do ta zhvilloni në sallën e madhe të koncerteve simfonike. Sidomos mister Xhejn Oullks ka çfaqur një interesim të jashtëzakonshëm. Ai bëri çmos që ta siguronte atë sallë dhe është interesuar vetë për reklamën dhe shpërndarjen e ftesave. Sjellja e Xhejn më ka habitur shumë. Është e qartë si drita e diellit se leksioni juaj cënon seriozisht interesat e tij, kurse mister...

— Njuxheks! — e ndërpreu Sidnej. — Ndaj monopolistëve nuk duhet ushqyer asnjë iluzion. Sa herë që të bëjnë një pritje të shkëlqyer, duhet të hapësh sytë më fort se kurrë. Padyshim, Xhejn s'ka aspak ndërmend të propagandojë suksesin e leksionit tim. Ai dhe mjekët e shoqërisë, Bell e Stjuart, do të bëjnë ç'është e mundur që leksioni im të dështojë dhe kjo t'u bëhet e ditur një rrethi sa më të madh dëgjonjësish e telespek-

tatorësh. Sidoqoftë, Njuxheks, do ta kem vështirë. Konkluzionet e mia, gjer më sot, janë bazuar në eksperimente të kryera në kafshë laboratorike, kurse ata duan të më kundërvënë eksperimentonjës të gjallë, njerëz të gjallë! Për këtë sapo më njoftoi dr. Edmond Dalo!

— Kjo nuk duhet lejuar, profesor! — thirri Njuxheksi. — Përfundimet e një eksperimenti të tillë mund të jenë fatale... Njerëzit duhen paralajmëruar për këtë...

— Do të bëjmë gjithçka që varet prej nesh... po mbase është vetëm një alarm i kotë i dr. Edmondit. Vetëm të çmendurit do të merrnin një guxim të tillë. Fundi, Xhejnit, Bellit dhe Stjuartit u dhimbset më fort koka e tyre, se sa e eksperimentonjësve, apo jo, Njuxheks?


— Mijëra dollarë do të justifikonin në vendin tonë edhe krimin më të shëmtuar, profesor!

Paskëtaj askush nuk foli më. Të pushtuar nga mendime të hidhura, morën drejtimin e hotelit të qytetit Salson.

* * *

Salla e madhe e koncerteve simfonike që mbushur atë mbrëmje si asnjëherë tjetër. Interesimi s'që aspak i rastit. Ditët e fundit, gazetat lokale kishin informuar gjerësisht lexuesit për polemikën e jashtëzakonshme, që parashikohej të zhvillohej midis profesor Sidnejit e kolegëve të tij, Bell e Stjuart. Xhejn i kishte deklaruar një gazetari më me influencë se humbja e profesor Sidnejit as që mund të vihej në dyshim. Madje, gazetat njoftonin për baste sensationale, që kishin filluar të viheshin midis përkrahësve të Sidnejit dhe atyre të Bell e Stjuart. Shkurt, tërë qyteti Salson jetonte në një ankth të papërshkrueshëm, në vigjiljen e betejës së madhe, siç e emërtonte gazetat, ndërmjet Sidnejit dhe përfaqësuesve monopolistë.

Më në fund, në orën 19, profesor Sidnej dhe ndihmësi i tij, dr. Njuxheksi, dolën në skenë, të shoqëruar nga një përfaqësues zyrtar i qytetit. Pas fjalës së përfaqësuesit, nën breshërinë e duartrokitjeve të stuhish-



me e thirrjeve entuziaste të përkrahësve, dhe të fishkëllimave, britmave të kundërshtarëve, e mori fjalën Sidnej.

Kishin kaluar dy orë nga koha kur ai kishte filluar leksionin. Edhe kundërshtarët më të flaktë qenë detyruar të praninin në heshtje forcën e madhe të mendimit të Sidnejit, veçanërisht pas disa pyetjeve të patsuksesshme të Bell dhe Stjuart, të bëra enkas për ta vënë në «trikëndëshin e boksit,» siç shpreheshin midis tyre dy mjekët. Më në fund u detyruan të heshtnin e të zinin të vetmin shteg të lirë, që u kish rekomanduar prej kohësh mister Xhejn.

— Ah, kolegë të nderuar, doni t'u provoj rrezikshmërinë e cigareve tuaja «Superfiltër»? Me gjithë zëmër! Doktor Njuxheks, ju lutem, më ndihmoni!..

Njuxheksi solli që prapa skenës një qen të madh leshtor, që ngjante më shumë me një ujk, dhe një pëllumb.

Në gojën e hapur të qenit, Sidnej pikoi dy pika nikotinë të pastër, të porsanxjerrë nga cigaret «Superfiltër». Kafsha ngordhi në çast nga kriza të papërmbajtshme dridhjesh. Mjaftoi më pak se çereku i pikës që të vihej re e njëjta gjë edhe te pëllumbi. Vështrimet e nemitura dhe disi të turbulluara të njerëzve në sallë qenë mbërthyer te kafsha dhe shpendi që s'lëviznin më.

— Mjafton 0,09 - 0,16 gram nikotinë e pastër për të shkaktuar vdekjen e njeriut, — u dëgjua zëri i Sidnejit.

— Duhet ditur se një paqetë «Superfiltër» përmban edhe ajo dozën vdekjeprurëse, po, në qoftëse qytetarët tanë të nderuar s'kanë pësuar asgjë gjer më sot, kjo është, padyshim, pasojë e piries graduale. Eks-trakti i nxjerrë nga 20 cigare «Superfiltër» do të shkaktonte një helmim absolutisht të sigurtë.

— Në asnjë rast, i nderuar profesor, — e ndërpreu me nervozizëm dr. Bell, — eksperimentet në kafshë nuk mund të shërbejnë si shkak për të menduar se një gjë

e tillë do të ngjante dhe me njerëzit, që në të vërtetë janë organizma shumë më të ndërlikuara e shumë më të qëndrueshme... Fundi, profesor, organizmat që eksperimentuat, e provuan për herë të parë këtë lloj helmi, sepse, besoj, s'keni kundërshtim, kafshët nuk pinë duhan, apo jo, Sidnej?

Përkrahësit e dr. Bell e Stjuart, që përbënin shumicën dërmonjëse (ata qenë ftuar posaçërisht me interesimin e drejtpërdrejtë të mister Xhejn), qeshën me të madhe dhe duartrokitën nxehtësisht.

—Unë do t'i jepja 500 dollarë atij që do të pinte i pari 100 cigare «Superfiltër» dhe 250 konkurentit, që do të klasifikohej i dyti. Për çdo cigare të pirë mbi të 100 cigaret, unë do të jepja nga 5 dollarë. Ne duhet t'i provojmë, të nderuarit profesor, se asgjë e tmerrshme nuk vjen nga pirja e cigareve, aq më shumë e cigareve tona «Superfiltër». Madje mjekët tanë, Bell e Stjuart, japin garanci të plotë për jetën e konkurentëve dhe, fundi, zotërojnë të gjitha kundërhelmet edhe në rast aksidenti, sidoqë... eh, kjo as që duhet të na shkojë ndërmend. — u hodh Xhejn i gjallëruar papritur.

— Do të provoj unë! — u hodh një djalosh i bëshëm, kuqalosh, me një fytyrë të gjerë, të mbushur me prenka. — Gjersa ju, mister Xhejn, jepni një garanci të tillë, do të qe marrëzi të humbisja rastin, apo jo? .

— Të lumtë, Herkul! — thirri i entuziazmuar Xhejn, duke i rrahur me forcë shpatullat e gjera prej atleti. — Edhe një konkurent tjetër... edhe një i dytë... Mos humbisni rastin për të fituar...

Me çape të ngadalshme, të lodhura, si të vinte pas një udhe të gjatë më këmbë, ngjiti shkallët e ngushta të skenës një djalosh rreth të 19-ve, me një fytyrë të zbetë, anemike.

— Mbase është i sëmurë! — mendoi Xhejn i pakënaqur, kur konkuronjësi kaptonte shkallën e fundit.

— Quhem Geni! — u prezantua djaloshi te Xhejn.

— Kam nevojë për ato para dhe dua të matem sonte... Xhejn u duk se s'i dëgjoi fjalët e djaloshit Gen.

Kishte rënë në mendime. Fundi, a duhej t'i trembej aq shumë fizikut të dobët dhe pamjes së sëmurë të konkurentit të dytë? Në qoftëse ai do të pinte 100 cigaret, kjo do të qe një goditje e tmerrshme dhe thuajse e pandreqshme për Sidnejin. A kishte reklamim më të vyer, se sa një eksperimentim i tillë?

— Shumë mirë! Edhe konkurenti i dytë është gati të luftojë për të fituar 500 dollarë, për të fituar një vit lumturi! — ju drejtua Xhejn publikut.

— Unë protestoj, protestoj — thirri me zemëratë Sidnej, që nuk mund t'u besonte syve të tij. — Ky është një eksperiment i përbindshëm, një eksperiment që do t'u sjellë vdekjen dy të rinjve, një vdekje të pashmangshme. Njerëz të ndershëm, ju nuk duhet të qëndroni indiferentë, nuk duhet të lejoni zhvillimin e këtij eksperimenti, të këtij basti të çmendur të mister Xhejnit...

— Ju nuk ndjeheni mirë, profesor! — i pëshpëriti Njuxheksi i shqetsuar. — Për fat të keq, ne s'do të mund të ndalim, ose, të paktën, t'u ndryshojmë rrjedhën ngjarjeve të kësaj nate.

— Ju, profesor, nuk mund t'u impononi njerëzve të lirë vullnetin tuaj! — tha doktor Stjuart. — Eksperimente të tilla, në prani të dy mjekëve specialistë, janë të ligjshme... ndaj...

Ai nuk mund të qëndronte më. Nuk do të pranonte kurrsesi të merrte pjesë në një bast kriminal.

I dërmuar, zbriti me përtesë shkallët e vogla të shkëlqyera dhe si një fantazmë përshkoi koridorin e ngushtë të sallës.

Tek mbyllte derën e jashtme, i erdhi e fuqishme në vesh jehona e thirrjeve të njerëzve në sallë, të pushuar nga ankthi. Po Xhejn s'do t'i linte të prisnin gjatë... të torturoheshin... Si të qe një garson i ri dhe i shkathët, i vuri secilit përpara nga pesë paqeta të markës «Superfiltër» dhe, si të drejtonte një ndeshje boksi (Xhejn ishte gjyqtar boksi), dha shenjën e fillimit të garës...

Geni kishte muaj të tërë që s'kishte vënë në gojë cigare aq të shtrenjta, sa ato të markës «Superfiltër».

Pa mbaruar së thithuri gjer në fund njëren cigare, Xhejn e Bell u ndiznin cigaren tjetër. Me një lëvizje të buzëve, kundërshtarët flaknin fundin e cigares, që duhej të ishte jo më i madh se 2 cm. dhe nxitonin të fusnin në gojë cigaren tjetër. Në mbarimin e paqetës së parë, dy të rinjtë u mbushën me besim të madh në forcat e tyre.

— Më vjen keq për të 500 dollarët tuaj! — i buzëqeshi Tomi me dashamirësi mister Xhejnit, ndërsa ky i fundit, i ofronte cigaren e parë të paqetës së dytë.

— Aspak, i dashur! Duhet t'ju vijë keq për të gjorin Sidnej! — tha me një ton ironik mister Xhejn dhe nënqeshi.

Tashmë dy kundërshtarët qenë nxehur mirë e gjallëruar. Thithnin të kënaqur njëren cigare pas tjetrës dhe u buzëqeshnin të gjithëve.

— Euforia, kënaqësia, faza e parë e helmimit, — tha me vete, i pikëlluar, dr. Njuxheksi, që kishte qëndruar në një nga kolltukët e radhës së parë dhe ndiqte së afërmi eksperimentin.

— Tomi 40 cigare, Geni 34 cigare! Ndryshimi vazhdon të mbetet po ai! — thirri Xhejn. Geni mbase do të ishte më i gëzuar, nëqoftëse s'do të qe pushtuar pas pak nga një ndjenjë e çuditshme: i dukej sikur e gërryenin me furçë ezofagun, stomakun dhe zorrët.


— Ç'është kështu, ç'po ndodh me mua? Sikur më gërryejnë përbrenda me një furçë tmerrësisht të ashpër! — ju drejtua mister Xhejnit.

— Ashtu të duket, Geni! S'është gjë! — u mundua ta qetsojë Xhejn, duke i buzëqeshur. — Ja, Tomi ka pirë më shumë e, megjithatë, e ndjen veten mirë, apo jo, Herkul?

Në vend të përgjigjes, nofullat e forta, muskuloze e të kërcyera të Tomit flakën tej fundin e lagur të cigares së 45-të.

— Edhe unë kam filluar të ndjej diçka të papërcaktuar, po s'është gjë! Jepmëni cigaren, Xhejn! — tha Tomi pas pak.

— Tomi 45 cigare! Geni 38 cigare! Filloi të mbetet



ca prapa djaloshi ynë. Sidoqoftë, inkurajimet tuaja, spektatorë të nderuar, do t'i japin të kuptojë këtij konkurenti, jo më pak të fuqishëm, se s'është i vetëm, se me të është publiku ynë i zgjedhur, i tërë qyteti Salson është me të. — Salla shpërtheu në duartkrotitje të stuhishme dhe: në thirrjet Geni, Geni, Geni!

Mbase në fillim thirrjet inkurajuese do ta kishin gjallëruar Genin e mbase do të qe përpjekur më me shpirt për t'ja kaluar kundërshtarit të fuqishëm; po tani aq i bënte! Kjo zhurmë filloi t'i bëhej e padurueshme, sepse që në orëgaren e 35-të e pushtuan kriza të forta dhembjeje të kokës. Megjithatë, ai s'duhej të tërhiqej. Jo! Do të mbaronte me çdo kusht të 100 cigaret «Superfiltër» dhe do të merrte 250 dollarë, një shumë jo e vogël për një të papunë si ai. Para së gjithash, atë mbrëmje do të hante në restorantin «Evropa», më të mirin e qytetit Salson. Ai përfytyroi sytë e çakëritur nga habia të kamerieres simpatike Brixhida tek vështronte qindra dollarë në portofolin e tij, dhe vuri buzën në gaz. Pas këtij parafytyrimi, ai qe i detyruar të pështynte pas çdo cigareje të thithur, ndonëse s'kish menduar më për gjellërat e shijshme të restorantit.

— Tomi 75 cigare, Geni 55 cigare! — dëgjoi zërin e humbur të mister Xhejn. Ju duk se Xhejn foli prapa një perdeje të trashë metalike. Sytë e mjegulluar të Genit u ngulën si të habitur te mister Xhejn. «Çudi e madhe, si u zvogëlua kështu Xhejn? Ej, çfarë xhuxh-marxhushi qesharak! Na ç'vend ke ardhur, more Xhejn? Nga vendi i shkurtabiqëve?»

— Çfarë ke? S'je mirë? — pyeti Xhejn i shqetsuar.

— Jo, jo, s'kam gjë... Se si m'u duk!... — u përgjegj Geni, duke mbledhur me mundim veten.

* * *

— Të lumtë Tomi, Herkuli ynë! 100 cigare! 100 cigare të markës sonë «Superfiltër» kaluan një provë sa të vështirë, aq edhe të lavdishme! Një triumf i plotë për shkencëtarët tanë Bell e Stjuart! Si?! Kërkon të pish

edhe më?! E pabesueshme, zotrinj të nderuar! Një urra për Tomi Herkulianin. — Salla jehoi e tëra nga thirrjet entuziaste.

— Po Geni? Geni! Sa ka pirë? — pyeti turma kurreshtarë.

— E 96-ta cigare «Superfiltër», — ju përgjegj Xhejn, duke i zgjatur djaloshit cigaren e porsandezur. — Sonte do të jeni djemtë më të lumtur, heronjtë e qytetit Salson! — u pëshpëriti ai.

Po dukej se Geni s'kishte dëgjuar asgjë. Filloi të dridhej i tëri përpara syve të Xhejnit, të dridhej jashtë mase.

— Mbahu, Geni! — tha Xhejn për t'i dhënë zemër dhe i rrahu lehtë shpatullat e ngushta e të dobëta.

Buzëve të mavijosura, të pushtuara nga një dridhje e papërmbajtshme, u shpëtoi fundi i qullur i cigares së 96-të, i cili ra përpara këmbëve, që dridheshin edhe ato, si të qenë kërcej të hollë kallamishtesh. Gishtrinjtë, që luhateshin nga dridhjet e mëdha, shtrënguan me mundim cigaren e 97-të dhe me vështirësi ja afruan gojës së shtrembëruar.

— Hë de, Geni! Mos u jep! Thith me të gjitha mushkëritë! Më fort, më fort, Geni! Edhe pak, edhe pak dhe të 250 dollarët do të përkasin ty, — përpiquej ta gjallëronte Xhejn.

Ai kishte arritur gjer në gjysmën e cigares së 97, kur befas, nga goja, i shpërtheu një shkumë e bollshme e verdhë. Geni mezi mbahej në këmbë. Si një i dehur, ai bëri përpara, drejt mister Xhejnit, tri hapa i pasigurtë, gati në të rënë. Diç belbëzoi nëpër dhëmbë, duke dashur të thotë diçka, po befas, me një thirrje ngjethëse, si të mbytej, vuri duart në grykë, duke dashur të çlirohej nga një nyje e pazgjidhshme, që i zinte frymën, dhe u përplas pa ndjenja në dysheme.

Sytë e hapur jashtë mase të të helmuarit dukej se qenë mbërthyer edhe tani te Xhejni. I tmerruar nga ai vështrim, ky u mënjanua pak, duke ju afruar mjekëve Bell e Stjuart, të zbehur edhe ata për vdekje, duke lënë të zbulohej kufomën që u duk se qeshi me një dhembje e sarkazëm të tillë, sa të gjithë ata që qenë në sallë u mblodhën kruspull të zhgënjyer, fajtorë dhe të tmerruar.

PASQYRA E LËNDËS

	Faqe
Dy fjalë prindërit dhe mësuesit	3
Chorea Minor	5
Kthjelltësia	11
Tinguj të harruar	20
I verbëri i errësirës	31
Zhënjimi	37
I përgjumuri	44
Daltonisti i vogël	52
Belbëzimi	59
Rrëzimi	60
Delirium tremens	75
Basti i çmendur	91

53639

BIBLIOTEKA E SHKENCËVE